

1 E mërkurë, 23 prill 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 10.05

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e seancës, ju lutem, paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës, kjo është kjo është çështja KSC-BC-2020-06,
11 Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Rexhep Selimit,
12 Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Për procesverbal ju them që z. Krasniqi po na ndjek
15 përmes videolidhjes pasi ka marrë lejen përkatëse; ndërkohë që
16 z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi janë të pranishëm në sallën
17 a gjyqit. Gjithashtu, vërej që znj. Alagendra dhe z. Roberts
18 po na ndjekin përmes videolidhjes sipas kërkesës së tyre dhe
19 Zëvendësadministratori është i pranishëm në sallën e gjyqit.

20 Së pari, sikurse ju kemi komunikuar përmes mesazhit
21 elektronik përpara një jave Trupi Gjykses dëshiron që të
22 dëgjojë parashtimet me gojë nga Mbrojtja e z. Thaçi në
23 përgjigje të -- në kundërpërgjigje të përgjigjes së ZPS-së për
24 parashtimin F03132 që është çështje për kalendarin. Nuk e di
25 në qoftë se keni komente të tjera. Fjala është për juve,

1 Mbrojtësi i z. Thaçi.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

3 Mirëmëngjes të gjithëve.

4 Neve vazhdojmë t'i qëndrojmë kërkesës tonë që kërkojmë
5 një procedurë të degëzuar sepse Mbrojtja e Thaçit nuk synon që
6 të dorëzojë një mocion *in limine*.

7 Situata sot është pak ndryshe krahasimisht me situatën
8 kur ne kemi dërguar kërkesën tonë për sa i takon mocionit ose
9 kërkesës *in limine* dhe kur Trupi Gjykses ka marrë vendimin e
10 tij lidhur me këtë. Përkatësisht, që është hapur një çështje
11 tjetër gjyqësore penale kundër z. Thaçi në Çështjen 12.

12 Kërkesa e ZPS-së kërkon që të lëvizë materiale të cilët
13 janë pjesë e Çështjes 12, në këtë çështje të sotme, pra në
14 Çështjen 06. ZPS-ja argumenton që ka tre materiale që janë me
15 rëndësi për Çështjen 06, duke argumentuar se së pari është e
16 provuar që ato përbëjnë faktorë rëndues që kanë lidhje me
17 dënimin në këtë çështje; së dyti, ata pretendojnë të
18 informojnë besueshmërinë e dëshmitarëve të ZPS-së në këtë
19 çështje; dhe së treti, ata pretendojnë që të demonstrojnë *mens*
20 *rea* të pretenduar prej tyre për sa i takon krimeve të cilët
21 ngrihen në aktakuzë.

22 Z. Thaçi ka të drejtën që të dorëzojë një mocion të ri *in*
23 *limine* dhe të kërkojë gjithashtu mjete juridike përkatëse duke
24 marrë parasysh, ndërmjet të tjerash, që çështje të reja kanë
25 lindur nga z. Thaçi, dhe duke marrë parasysh gjithashtu e ZPS-

1 së që ka të bëjnë me marrjen e disa prej provave të Çështjes
2 12 dhe transferimit të tyre në Çështjen 06.

3 Mocioni i ZPS-së ngre disa çështje të cilat cenojnë disa
4 prej të drejtave themelore të z. Thaçi, përfshirë këtu të
5 drejtën për proces të drejtë juridik, gjithashtu edhe për sa i
6 takon të drejtës për vetëdiskriminim duke e vendosur Mbrojtjen
7 në një pozitë të pafavorshme dhe duke i caktuar gjithashtu
8 edhe barrën e parakohshme të Mbrojtjes për të trajtuar
9 materiale të Çështjes 12. Ndërkohë kemi parimin *ne bis in*
10 *idem*, i cili është shumë i qartë dhe i kërkon Prokurorisë që
11 të kërkojë që Dhomat e Specializuara të Kosovës të dënojnë z.
12 Thaçi -- të mos e dënojnë z. Thaçi dy herë. Domethënë, vetë ky
13 parim *ne bis in idem* nuk bën të mundur dënimin dy herë për të
14 njëjtat vepra.

15 Së treti, kemi parimin e *res judicata* ose gjykimit të
16 drejtë, i cili eventualisht kërkohet që të trajtohet dhe që i
17 kërkon ZPS-së që të ndalohet nga ngritja e çështjeve penale
18 kundër z. Thaçi në dy çështje gjyqësore të ndryshme për të
19 njëjtën sjellje të tij.

20 Së katërti, kemi të drejtën për kohë të përshtatshme dhe
21 gjithashtu përgatitjen siç implikohet z. Thaçi, ndërkohë që
22 duhet që z. Thaçi të ketë të drejtë që të dorëzojë një mocion
23 dhe synojmë që ta bëjmë këtë gjë brenda një periudhe të
24 shkurtër.

25 Qëndrimi ynë është që kjo është vetmja çështje që Trupi

1 Gjykues duhet që të trajtojë njëkohësisht dhe mocioni *in*
2 *limine*, pra duhet të bëhet veçmas nga mocioni i ZPS-së.

3 Po ashtu më lejoni të them që Trupi Gjykues ka vendosur
4 në disa raste kur ne, Mbrojtja ose palët e tjera nuk iu dhënë
5 mundësia që nuk mund të kërkojë mjete juridike në formën e
6 përgjigjes së një mocioni tjetër. Në qoftë se doni më shumë
7 informacion lidhur me këtë pikë atë mund ta gjeni në
8 parashtrimin F01359, në paragrafin 11; F01737, paragrafi 17;
9 dhe F0177 [Sipas përkthimit], paragrafi 17. Ne do të kërkojmë
10 më tepër mjete juridike përveçse të mohohen përpjekjet e ZPS-
11 së për të lëvizur disa prej materialeve në Çështjen 12 në
12 Çështjen 06.

13 Nëse Trupi Gjykues do të mohojë të drejtën e z. Thaçi që
14 të dorëzojë një mocion *in limine*, ne duam që të dëgjojmë
15 Trupin Gjykues se cilat janë alternativat. Megjithatë,
16 qëndrimi ynë është që nuk ka arsye që të mos na jepet e drejta
17 që të dorëzojmë një mocion, dhe çështja që shtrohet këtu është
18 si të strukturohet ky mocion. Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
20 z. Misetic. Do ta shqyrtojmë këtë çështje dhe sigurisht që do
21 të japim një vendim lidhur me të sot më vonë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni dua që të
23 ngre diçka për momentin. Atëherë, përgjigja jonë për mocionin
24 e ZPS-së e ka afatin të bëhet deri të premtën, kështu që do ju
25 kërkonim që ta zgjasnim këtë afat kohor në vartësi të

1 përgjigjes ose të vendimit që do merrni ju më vonë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Edhe për këtë do të marrim vendim në të njëjtën kohë.

4 Vazhdojmë më tej. Trupi Gjykses vëren që dje Mbrojtja
5 kërkoi përmes mesazhit elektronik një shtim tjetër të fjalëve
6 me 3000 fjalë për kërkesa -- për përgjigjen ndaj mocionit të
7 konsoliduar të Prokurorisë për pranimin e provave në pajtim me
8 rregullat 153, 155 dhe kërkesa lidhur me to, që është
9 parashtimi F02056.

10 ZPS-ja dëshiron t'i përgjigjet kësaj kërkesë për shtim të
11 fjalëve?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po Mbrojtja
14 dëshiron të shtojë diçka tjetër? Duket se jo.

15 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke marrë
17 parasysh që Mbrojtjes i është miratuar kërkesa për një shtim
18 prej 2000 fjalësh më përpara, Trupi Gjykses është i mendimit
19 që shtimi me 3000 fjalë të tjera është i tepërt. Trupi Gjykses
20 është i bindur që zgjatja me 1000 fjalë është e mjaftueshme në
21 mënyrë të tillë që Mbrojtja të trajtojë siç duhet çështje që
22 ngrihen në mocionin e ZPS-së.

23 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se ka arsye të
24 vlefshme për shtimin me 1000 fjalë të përgjigjes së Mbrojtjes
25 ndaj parashtimit F03056 dhe miraton këtë shtim.

1 Ne kemi një rend dite për ditën e sotme, megjithatë,
2 përpara sesa të kalojmë tek rendi i ditës kemi disa urdhra me
3 gojë që dëshiroj që të jap, të lëshoj, duke marrë parasysh dhe
4 çështje të tjera të cilat janë ngritur gjatë gjykimit dhe të
5 cilat nuk janë trajtuar deri tani. Kemi rreth dhjetë urdhra.
6 Do të përfundojmë me këto urdhra, do të bëjmë një pushim prej
7 dhjetë minutash dhe pastaj do të vazhdojmë rendin e ditës
8 sikur ja u kam dërguar të gjitha palëve.

9 Së pari është një urdhër gojor që ka të bëjë me
10 riklasifikimin e deklaratave të Dëshmitarit 04264 për pranimin
11 e versioneve të redaktuar publike të provës P01955.1.

12 Trupi Gjykses vëren se më 24 mars 2025, mbi bazën e
13 kërkesën së ZPS-së, Trupi Gjykses ka urdhëruar riklasikimin e
14 Pjesëve 2 deri në 9 të transkripteve dhe të regjistrimeve
15 audio-vizive të Dëshmitarit të Prokurorisë 04264 dhe vetëm
16 Pjesa 1 e kësaj interviste duhet që të mbetet konfidenciale.
17 Këtu i referohem versionit në anglisht dhe në shqip të
18 transkripteve të intervistës së Dëshmitarit të Prokurorisë
19 04246 që janë pranuar si prova materiale P01955.1 deri në
20 P01955.9 dhe regjistrimet përkuese audio-vizive të tyre.

21 Pasi kemi rishikuar klasifikimin e deklaratave të mbetura
22 të Dëshmitarit 04264 dhe duke marrë parasysh parashtrimet e
23 ZPS-së në mesazhin elektronik të datës 20 janar 2025, Trupi
24 Gjykses është i bindur që prova P01956, P01963 dhe P01964 dhe
25 përkthimet e tyre mund të riklasifikojë gjithashtu si publike,

1 dhe udhëzon Zyrën Administrative që të vijojë duke i
2 riklasifikuar ato.

3 Më tej, Trupi Gjykses vëren që ZPS-ja kanë kërkuar për
4 pranim në prova përmes postës elektronike versionet e
5 redaktuar publike në anglisht dhe në shqip të Pjesëve 1 të
6 transkriptit të intervistës së Dëshmitarit të ZPS-së 04264 që
7 është pranuar si prova P0155.1_ET [Sipas përkthimit] dhe
8 P01955.1_AT dhe klasifikuar si konfidenciale. Versionet e
9 redaktuara publike në anglisht dhe në shqip që janë kërkuar
10 për t'u regjistruar si prova materiale janë dokumentet me
11 numra ERN-je 054739-TR-ET Pjesa 1 RED PRV dhe 054739-TR-AT
12 Pjesa 1 e Rishikuar RED PRV, përkatësisht.

13 Në qoftë se ka kundërshtime nga ekipet e Mbrojtjes për
14 pranimin e versioneve të redaktuara publike të provës
15 P01955.1, ju lutem na e bëni me dije tani në qoftë se keni
16 kundërshtime. Nuk dëgjuam ndonjë përgjigje. Faleminderit.

17 Pasi dokumentet -- versionet në anglisht dhe shqip të
18 provës P01955.1 si të pranueshme, Trupi Gjykses është i bindur
19 gjithashtu që versionet përkuese të redaktuara publike janë të
20 pranueshme. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses pranon në prova
21 gjyqësore dokumentet 054739-TR-ET Pjesa 1 RED PRV dhe 054739-
22 TR-AT Pjesa 1 *Revised* RED PRV në prova gjyqësore, si dhe
23 udhëzon Zyrën Administrative që t'i caktojë këtyre dokumenteve
24 numrat e provave që përkojnë me versionet konfidenciale, si
25 dhe të klasifikojë versionet e redaktuara publike të pranuar

1 si publike.

2 Ky është fundi i urdhrit të parë gojor.

3 I dyti është urdhër gojor që ka të bëjë me parashtimin e
4 protokolluar F02437.

5 Trupi Gjykses tani do të vendosë lidhur me parashtimin
6 F02437, ku në pajtim me urdhrin gojor të katër të Trupit
7 Gjykses në datë 15 janar 2024, Prokuroria kërkoi të pranonte
8 në prova gjyqësore regjistrimet audio-video të deklaratave të
9 dëshmitarit që janë pranuar më parë në pajtim me rregullën
10 143(2) (c) .

11 Trupi Gjykses vëren që parashtimi i ZPS-së kërkon
12 pranimin e segmenteve të videos me orët e shënuara në Shtojcën
13 1, dhe ato përkojnë me pjesët e pranuar të deklaratave. Trupi
14 Gjykses konsideron se vetëm ato pjesë të videos që përkojnë me
15 orët e shënuara të deklaratave duhet që të pranohen në prova.
16 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses udhëzon ZPS-në që të përgatisë
17 fragmente të regjistrimeve përkatëse në audio-video që
18 përkojnë me pjesët përkatëse të deklaratave, jo më vonë sesa
19 të premtën, 2 maj 2025.

20 Pasi ka konstatuar që deklaratat përkatëse janë të
21 pranishme -- të pranueshme - më falni - në pajtim me
22 rregullën 143(2) (c), Trupi Gjykses pranon në prova gjyqësore
23 pjesët përkatëse të regjistrimeve audio-video të këtyre
24 deklaratave ose të pjesëve të tyre sikurse ato janë
25 identifikuar në Shtojcën 1 të parashtimit F02437, dhe udhëzon

1 Zyrën Administrative që t'i caktojë regjistrimeve të pranuara
2 audio-vizive të njëjtat numra provash të cilat janë caktuar në
3 deklaratat përkatëse sikurse është përcaktuar në Shtojcën 1 të
4 parashtimit F02437.

5 Më tej, Trupi Gjykses udhëzon ZPS-në të bëjë parashtime
6 lidhur me klasifikimin e regjistrimeve të pranuara audio-
7 vizive, jo më vonë sesa të mërkurën, 30 prill 2023 [Sipas
8 përkthimit].

9 Kjo përfundon urdhrin e dytë gojor.

10 Urdhri i tretë gojor ka të bëjë me kërkesë për të pasur
11 qasje në parashtimin konfidencial në Çështjen 04, 05 dhe 07,
12 që janë parashtimet F03062, F03063.

13 Trupi Gjykses tani vëren që me 27 mars 2025, në
14 parashtimin F03062, Mbrojtja e Veselit ka kërkuar qasje dhe
15 përdorim të parashtimeve të përzgjedhura konfidenciale nga
16 lënda gjyqësore 04, 05 dhe 07 përpara Dhomave të
17 Specializuara.

18 Më 28 mars 2025, në parashtimin F03063, Mbrojtja e
19 Thaçit iu bashkua kërkesës.

20 Më 7 prill 2025, në parashtimin F03091, ZPS-ja deklaroi
21 që ajo nuk kundërshton që Mbrojtja të ketë qasje në
22 parashtimet e identifikuara në Lëndët 04 dhe 05. Megjithatë,
23 ZPS-ja kundërshton kërkesën e Mbrojtjes për të pasur qasje në
24 parashtimet konfidenciale të Çështjes 07, pasi parashton që
25 nuk ka qëllim legjitim forenzik të dëshmuar prej Mbrojtjes.

1 Mbroytja nuk u kundërpërgjigj.

2 Masat mbrojtëse që janë caktuar në Lëndën 04, 05 janë
3 urdhëruar nga Trupi Gjyqësor I. Masat mbrojtëse për Lëndën 07
4 janë urdhëruar nga Trupi Gjykues II.

5 Trupi Gjykues, në pajtim me rregullën 81(4), ka kërkuar
6 dhe ka marrë pikëpamjet e Trupit Gjykues I lidhur me këtë
7 kërkesë.

8 Më 18 prill 2025, Gjykatësit e Trupit Gjykues I thanë se
9 nuk ka arsye për të mbajtur versionet e redaktuara publike në
10 raport me Trupin Gjykues II ose palët dhe Mbrojtësin e
11 Viktimave në Çështjen 06, dhe për këtë qëllim, pra, nuk ka
12 arsye për të mbajtur redaktimet e përfshira në versionet e
13 redaktuara publike në parashtimet e përzgjedhura të Lëndës
14 04, dhe 05.

15 Sa i takon parashtimit për Lëndën 07, Gjykatësit e
16 Trupit Gjykues numër II, në kapacitetin e tyre si gjykatës që
17 kanë urdhëruar masat mbrojtëse në Çështjen 07 kanë rishikuar
18 parashtimet përkatëse dhe konsiderojnë që nuk ka arsye që të
19 ruhen redaktimet në raport me Gjykatësit e Trupit Gjykues
20 numër II, në cilësinë e tyre si gjykatës të Çështjes 06, ose
21 palëve ose Mbrojtësve të Viktimave në Çështjen 06. Pra, nuk ka
22 arsye që të ruhen redaktimet e përfshira në versionet e
23 redaktuara publike të këtyre parashtimeve.

24 Trupi Gjykues vëren që Mbrojtja e Veselit ka identifikuar
25 dokumente për të cilat kërkohet qasje në pajtim me

1 jurisprudencën e mëparshme të Trupit Gjykues dhe në pajtim me
2 jurisprudencën e tribunalëve kriminalë ndërkombëtarë të tjerë.

3 Trupi Gjykues është i mendimit që ka një qëllim specifik
4 forenzik legjitim për sa i takon qasjes së kërkuar nga
5 Mbrojtja e Veselit dhe e Thaçit për përzgjedhjen e
6 parashtrimeve konfidenciale të Lëndëve 04, 05, dhe 07. Në këtë
7 aspekt Trupi Gjykues vëren që Lëndët 04 dhe 05 mbivendosen në
8 një mënyrë të kufizuar me procedurën aktuale. Përveç kësaj,
9 Trupi Gjykues konsideron që qasja në parashtrimet e
10 identifikuara të Lëndës 07, mund të ndihmojnë Mbrojtjen në
11 këtë lëndë gjyqësore për të bërë parashtrime lidhur me
12 mocionet e mundshme në pajtim me rregullën 130, që Mbrojtja ka
13 thënë që synon të dorëzojë dhe në mënyrë përjashtimore orë
14 miraton qasjen e Mbrojtjes në këto parashtrime mbi arsyetimin
15 e dhënë më sipër.

16 Sa i takon mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave, Trupi
17 Gjykues vëren se në pajtim me rregullin 81(1)(a) masat
18 mbrojtëse të urdhëruara në procedura të tjera do të vazhdojnë
19 të kenë efekt *mutatis mutandis* dhe në Lëndën 06. Trupi Gjykues
20 më tej vëren se gjykatësit e Trupit Gjykues të caktuar për
21 Lëndën 04, 05, dhe 07 konsiderojnë që nuk ka arsye për të
22 mbajtur redaktimet e përfshira në versionet e redaktuara
23 publike të parashtrimeve të përzgjedhura. Duke marrë parasysh
24 sa më lart, Trupi Gjykues është i bindur që miratimi i
25 kërkesës do ishte një pajtim me nevojat për të siguruar

1 mbrojtje të dëshmitarëve dhe viktimave, me kusht që
2 parashtimet e përzgjedhura të mbeten konfidenciale në Lëndën
3 06.

4 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses autorizon qasje dhe përdorim
5 të versioneve konfidenciale të parashtimeve të përzgjedhura
6 në Lëndët 04, 05 dhe 07, sikurse identifikohet në kërkesën
7 F03062, paragrafi 18, për Trupin Gjykses numër II, dhe palët
8 dhe Mbrojtja e Viktimave në Lëndën 06.

9 Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative që të sigurojë
10 që Trupi Gjykses numër II, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave në
11 Lëndën 06 të kenë qasje në versionet konfidenciale të
12 parashtimeve të përzgjedhura.

13 Së fundi, Trupi Gjykses i kujton palëve dhe pjesëmarrësve
14 të klasifikimit konfidencial të këtyre parashtimeve se, në
15 pajtim me rregullën 82(1)(b), pjesët konfidenciale nuk duhet
16 t'i nxirren publikut.

17 Ky është fundi i urdhrit të tretë gojor.

18 Urdhri numër katër lidhur me materialin 4D0091 [Sipas
19 përkthimit] me numër provizor dhe 4D000092 po ashtu me numër
20 provizor.

21 Më 30 tetor -- më falni -- po edhe një herë. Më 30 tetor
22 2024, Trupi Gjykses shënoi një dokument me numër reference
23 105714-105724 për identifikim dhe i dha numrin përkatësisht
24 4D0091 [Sipas përkthimit] dhe një dokument tjetër që kishte
25 numrin e referencës DJK01084-ET-DJK01096-ET me numrin provizor

1 4D0092 [Sipas përkthimit].

2 Dokumenti i parë është një raport zyrtar, ndërsa
3 dokumenti i dytë është një artikull i hapur që vjen nga burime
4 të hapura, që e ka titullin "Zjarri i sekreteve shtetërore".

5 Mbrojtja kërkoi që të pranoheshin këto dokumente përmes
6 Dëshmitarit W04798.

7 ZPS-ja nuk kundërshtoi pranimin e këtyre dokumenteve.

8 Trupi Gjykses është bindur se relevanca e këtyre
9 dokumenteve është e vlefshme sepse Dëshmitari W04798 komentoi
10 për dokumente dhe përmbajtja e tyre është e mjaftueshme dhe
11 lidhet me provat në këtë çështje gjyqësore.

12 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur për
13 autenticitetin *prima facie* të dokumentit pasi kanë shënime të
14 origjinës, prejardhjes pra, përfshirë autorin dhe datën kur
15 është lëshuar dokumenti.

16 Sa i takon vlerës provuese, Trupi Gjykses është bindur
17 sepse është dhënë konteksti i mjaftueshëm lidhur me të dy
18 dokumentet dhe është -- më falni - përmbush kriterin *prima*
19 *facie*, të dokumenteve dhe nuk tejkalohet nga asnjë vlerë
20 cënuese.

21 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vlerëson se materiali 4D0091
22 [Sipas përkthimit] dhe materiali 4D0092 [Sipas përkthimit], të
23 dy me shënime provizore, përmbushin kriteret e rregullës 138
24 dhe i pranon si prova gjyqësore. Dokumentet marrin numrin
25 përfundimtar dhe i hiqet numri provizor.

1 Këtu mbyllet urdhri katër me gojë.

2 Urdhër me gojë sa i takon provës P00073.1, po ashtu me
3 numër provizor.

4 Do lëshojmë një urdhër me gojë për pranimin e materialit
5 P00973.1 si provë gjyqësore.

6 Trupi Gjykses rikujton se më 18 shtator -- shkurt - më
7 falni - 2025, gjatë dëshmisë së Dëshmitarit W04491, ZPS-ja
8 kërkoi pranimin e një dokumenti që kishte numrin ERN
9 SITF00423766-00423798 bashkë me përkthimin në gjuhën angleze,
10 të cilat morën numër provizor, në fakt, dhe iu dha numri
11 P0073.1 [Sipas përkthimit] dhe P00071.1_ET, që ishte një
12 version më i pastër i provës P0073 [Sipas përkthimit] dhe
13 përkthimit të saj.

14 Mbrojtja komunikoi përmes komunikimeve *inter partes* se
15 nuk kundërshtonte pranimin e materialit P00073.1 me numër
16 provizor.

17 Trupi Gjykses rikujton se më 11 maj 2023 doli në
18 përfundimin se prova P0073 [Sipas përkthimit] përmbushte
19 standardet e pranueshmërisë sipas rregullës 138. Edhe kjo
20 provë, në fakt, ishte një version më i qartë i provës P007.3
21 [Sipas përkthimit] dhe përkthimit të saj, e për rrjedhojë
22 Trupi Gjykses e pranon si provë gjyqësore edhe i kërkon Zyrës
23 Administrative t'i heqi numrin provizor kësaj prove.

24 Pika gjashtë është një urdhër me gojë për materialin
25 4D0093 [Sipas përkthimit] po ashtu me numër provizor, 4D0094

1 [Sipas përkthimit] me numër provizor, dhe 4D0095 me numër
2 provizor.

3 Ka disa dokumente që Trupi Gjykses i ka shënuar për
4 identifikim për të cilat tashmë do të japim vendimin tonë
5 përkatës.

6 Së pari, Trupi Gjykses rikujton se më 31 tetor 2024,
7 gjatë dëshmisë së Dëshmitarit W02758, Mbrojtja e Krasniqit i
8 tregoi dëshmitarit disa dokumente dhe kërkoi që të pranoheshin
9 më pas këto dokumente përkatësisht me numrat DJK01037 deri në
10 DJK01037, po ashtu DJK01038, DJK01039 dhe DJK01036 deri në
11 DJK01036, dhe përkthimet e tyre në gjuhën angleze. Trupi
12 Gjykses u dha numër provizor, përkatësisht numrat ishin 4D0093
13 [Sipas përkthimit], 4D0094 [Sipas përkthimit] dhe 0095.

14 Të tri dokumentet janë artikuj shtypi ku sugjerohet që
15 një viktimë e një krimi të pretenduar që përshkruhet në dosjen
16 paragjyqësore të Prokurorisë më vonë ishte dënuar për krime të
17 rënda dhe thuhet se i është -- ja ka mbathur drejtësisë.
18 Mbrojtja e Krasniqit argumenton se artikujt janë relevantë dhe
19 të rëndësishëm për të vlerësuar besueshmërinë e kësaj viktime
20 të pretenduar.

21 ZPS-ja kundërshtoi pranimin e tri dokumenteve, duke thënë
22 se besueshmëria ishte trajtuar më dëshmitarin sepse dëshmitari
23 ishte në gjendje t'u përgjigjej pyetjeve dhe nuk kishte nevoja
24 shtesë që të pranoheshin këto artikuj si prova gjyqësore.

25 Pasi shqyrtuam parashtimet e palëve, Trupi Gjykses

1 konstaton se tre dokumentet përmbushin kriteret *prima facie* të
2 rregullës 138.

3 Sa i takon relevancës, Trupi Gjykses vlerëson se tri
4 dokumentet janë relevante për besueshmërinë e personit që
5 pretendohet se është mbajtur i ndaluar nga UÇK-ja dhe për të
6 cilin shumë dëshmitarë, përfshirë dhe Dëshmitarin 04758, kanë
7 dhënë dëshmi. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se personi që
8 është objekt i këtyre artikujve nuk është thirrur për të dhënë
9 dëshmi. Relevanca e materialit lidhet me dëshminë e këtij
10 dëshmitari që pretendohet që ja ka dhënë një personi tjetër i
11 cili më pas erdhi dha dëshmi përpara këtij Trupi Gjykses.

12 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses vlerëson se të
13 tri dokumentet që janë artikuj që gjenden online të botuara
14 nga media të ndryshme dhe që kanë datën përkatëse janë
15 autentike *prima facie*.

16 Sa i takon vlerës provuese, Trupi Gjykses vëren se,
17 ndonëse saktësia e këtij informacioni që gjendet në artikujt
18 nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur, sidoqoftë këto
19 tre artikuj kanë data të ndryshme, vijnë nga burime të
20 ndryshme mediatike, citojnë burime të ndryshme dhe sugjerojnë
21 se viktima e pretenduar është dënuar për vepra të rënda penale
22 në Kosovë dhe është arratisur nga Kosova.

23 Trupi Gjykses konstaton se ndonëse dokumentet relevancën
24 e kanë shumë të vogël, kanë një lloj vlere provuese e cila
25 mjafton për të përmbushur standardin *prima facie*.

1 Trupi Gjykses vlerëson se pranimi i këtyre tri
2 materialeve nuk i kushton asnjë dëm palës tjetër, pasi janë
3 përdorur dhe diskutuar në sallën e gjyqit dhe palët dhe
4 pjesëmarrësit mund t'i kishin bërë pyetje të mëtutjeshme
5 dëshmitarit nëse gjykonin të nevojshme për ta bërë këtë gjë.
6 Rrjedhimisht, vlera provuese *prima facie* nuk tejkalohet nga
7 asnjë vlerë cenuese, nga asnjë efekt cenues - më falni. Fakti
8 që Dëshmitari 04758 nuk ishte në gjendje të komentonte në
9 mënyrë të njëmendtë për përmbajtjen e këtyre artikujve dhe se
10 personi në fjalë nuk ka ardhur këtu të trajtojë vërtetësinë e
11 kësaj përmbajtjes, do të merret parasysh kur t'i jepet pesha e
12 caktuar dhe vlera provuese këtyre materialeve.

13 Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses pranon
14 si prova gjyqësore materialet 4D0093 [Sipas përkthimit], 94,
15 dhe 95, dhe udhëzon Zyrën Administrative t'u heqi numrin
16 provizor.

17 Me kaq mbyll urdhrin e gjashtë me gojë.

18 Urdhri me gojë numër shtatë që ka të bëjë me materialin
19 1D00046 me numër provizor.

20 Trupi Gjykses tashmë do të vendosë lidhur me pranimin e
21 një dokumenti që ka marrë numrin e përkohshëm 1D0046 [Sipas
22 përkthimit].

23 Trupi Gjykses rikujton se, më 5 shtator 2023, gjatë
24 dëshmisë së Dëshmitarit W04018, Mbrojtja e Thaçit kërkoi që të
25 pranohej një ekstrakt i një aktgjykimi i Gjykatës Themelore të

1 Prishtinës. Dokumenti kishte numrin 032228, 03286 [Sipas
2 përkthimit] -- edhe një herë, 032286. Dhe dëshmitarit iu
3 tregua konkretisht faqja 032278, të cilës i dhamë numrin
4 provizor edhe numri ishte 1D0046 [Sipas përkthimit].

5 ZPS-ja kundërshtoi pranimin e materialit në fjalë për
6 shkak se i mungonte relevanca sipas tyre. ZPS-ja gjithashtu
7 theksoi konstatime të mëhershme të Trupit Gjykues sa i takon
8 mungesës së relevancës për pranimin e pjesëve të aktgjykimeve
9 si prova gjyqësore.

10 Pasi shqyrtuam parashtimet Trupi Gjykues konstaton se
11 dokumenti në fjalë nuk përmbush kriteret për pranim sipas
12 rregullës 138.

13 Sa i takon relevancës, Trupi Gjykues vlerëson se
14 materiali në fjalë përmban informacione relevante për akuzat e
15 ngritura në aktakuzë pasi lidhet me ekzistencën e pretenduar
16 të listave dhe/ose përdorimin e tyre prej UÇK-së si bazë për
17 ndalimin e kundërshtarëve të pretenduar të UÇK-së, mes të
18 cilëve dhe Dëshmitari W04018.

19 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykues është i bindur
20 se dokumentet që janë kërkuar për t'u pranuar, që në fakt
21 është pjesë e një aktgjykimi të Gjykatës Themelore të
22 Prishtinës, është autentik *prima facie*.

23 Sidoqoftë, sa i takon vlerës provuese Trupi Gjykues
24 fillimisht vëren se substanca e materialit në fjalë lidhet me
25 konstatime që janë bërë nga një tjetër trup gjykues bazuar në

1 dokumentacione të tjera edhe ne do të marrim vendim lidhur me
2 këtë. Sa i takon vendimeve të mëhershme, përshirë këtui dhe
3 urdhrin e dytë me gojë të 7 nëntorit 2024 dhe urdhrin e parë
4 me gojë të 30 janarit 2025, Trupi Gjykses përsërit se nuk e ka
5 për detyrim të pranojë konstatime që kanë bërë trupa të tjera
6 gjykses. Në këtë rast, Trupi Gjykses merr parasysh faktin se
7 ndryshe nga rastet e tjera kur është lejuar një pjesë e një
8 aktgjykimi për çështje konteksti, siç ka qenë në rastin e
9 dokumentit F01783 [Sipas përkthimit], ky porcion i këtij
10 aktgjykimi lidhet vetëm me përgjegjësinë e Trupit Gjykses, pra
11 është përgjegjësi e Trupit Gjykses të vlerësojë faktet
12 përkatëse që janë të ngritura në aktakuzë dhe që diskutohen
13 mes palëve. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vlerëson se dokumenti
14 në fjalë nuk ka vlerë provuese të mjaftueshme për të
15 përmbushur pragun *prima facie*.

16 Duke mbajtur këtë parasysh Trupi Gjykses rrëzon pranimin
17 e materialit 1D0046 [Sipas përkthimit] si provë gjyqësore dhe
18 këtui mbyll urdhrin e shtatë me gojë.

19 Tani do vendosim lidhur me pranimin e një dokumenti që po
20 ashtu ka numër provizor 1D0074.

21 Trupi Gjykses rikujton se, më 6 dhjetor 2023, gjatë
22 dëshmisë së Dëshmitarit W02161, Mbrojtja e Thaçit kërkoi të
23 pranohej një dokument që kishte numrin DHT02782-DHT02783 dhe
24 përkthimi në gjuhën angleze. Kjo është reflektuar në
25 transkript në faqen 10701. Duke mbajtur parasysh

1 mospërputhshmëritë e caktuara sa i takon përkthimit me shkrim,
2 Trupi Gjykses udhëzoi Mbrojtjen e Thaçit të dorëzonte një
3 rishikim të përkthimit edhe iu dha dokumentit numër provizor
4 1D0074 [Sipas përkthimit].

5 Trupi Gjykses vëren se në përputhje me udhëzimet e Trupit
6 Gjykses, më 6 dhjetor 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një
7 përkthim të rishikuar të anglishtes të dokumentit të fjalë.

8 ZPS-ja kundërshtoi pranimin e dokumentit duke argumentuar
9 se nuk e dinte kush ishte autori dhe burimi, dhe se dokumenti
10 ishte i ishte shfaqur dëshmitarit dhe dëshmitari nuk kishte
11 asnjë dijeni lidhur me këtë artikull.

12 Sa i përket relevancës Trupi Gjykses vlerëson se
13 dokumenti që kërkohet të pranohet është relevant, në fakt, për
14 dëshminë e Dëshmitarit 026 -- 161, për sulmet e pretenduara që
15 kanë ndodhur në Kosovë në 1998 dhe 1999 kundër serbëve të
16 Kosovës dhe shqiptarëve.

17 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses vlerëson se
18 dokumenti në fjalë, që në fakt është thjesht një artikull
19 online i botuar nga *Kurir* më 18 janar 2024, është *prima facie*
20 autentik. Origjina dhe burimi janë të qarta që në pamje të
21 parë të dokumentit.

22 Sa i takon vlerës provuese, Trupi Gjykses vëren se
23 artikulli është mbështetur krejtësisht në një intervistë me
24 një person edhe me medias *Kurir*, pa përmendur burime të tjera
25 të cilat nuk janë diskutuar fare në këtë proces gjyqësor dhe

1 për të cilat nuk është dhënë dëshmi në sallën e gjyqit.

2 Rrjedhimisht, dëshmitari nuk ishte në gjendje të komentonte
3 për artikullin.

4 Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se aspektet e ngritura në
5 artikull janë mbuluar dhe në provën 1D0075 [Sipas përkthimit],
6 i cili i është treguar dëshmitarit gjatë kundërpjetjeve dhe
7 është pranuar si provë gjyqësore. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses
8 është bindur se prova 1D00 -- 1D00074 ka një lloj vlere
9 provuese. Por, mungon origjina dhe besueshmëria e këtij
10 informacionit dhe kështu dokumenti nuk mund të merret për bazë
11 për të shkak -- mungon vërtetësia e përmbajtjes, nuk mund ta
12 verifikojmë vërtetësinë e përmbajtjes.

13 Për këto arsye, Trupi Gjykses vlerëson se, në fakt,
14 materiali 1D0074 [Sipas përkthimit] i përmbush kriteret për
15 pranueshmëri sipas rregullës 138. Prandaj, e pranojmë si provë
16 gjyqësore, por për qëllimin e kufizuar që e cekëm më lart edhe
17 udhëzojmë Zyrën Administrative t'i heqi numrin provizor.

18 Këtu mbyll urdhrin e tetë me gojë.

19 Edhe një tjetër. Trupi Gjykses tani do të vendosë lidhur
20 me pranimin e provës P01199 MFI, me numër provizor pra.

21 Ju lutem të kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani

4 përfundova me urdhrat me gojë edhe përpara se të fillojmë me

5 rendin e ditës së sotme do bëjmë dhjetë minuta pushim. Në

6 rregull kthehemi pas dhjetë minutash dhe vazhdojmë me pikat në

7 rendin e ditës siç jua kemi dërguar.

8 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

9 --- Seanca ndërpritet në orën 10.50

10 --- Seanca rifillon në orën 11.01

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni po

12 pata një problem me pajisjen e dëgjimit.

13 Tani do të trajtojmë programin që ju kam -- ju kemi

14 dërguar së fundmi. Do t'i kalojmë të gjitha pikat e programit

15 një nga një deri në fund, pastaj me shpresë, pasi të dëgjojmë

16 përgjigjet tuaja, informacionin që do të jepni do të bëjmë një

17 pushim deri pas dreke. Kështu që në orën 2.30 do të kthehemi

18 dhe do të japim disa urdhra gojorë për t'u trajtuar çështjet

19 që mund të dalin gjatë diskutimeve që do të kemi.

20 Tani po filloj duke pyetur ZPS-në të na konfirmojnë që i

21 kanë paraqitur tërësisht provat e tyre dhe s'u ka mbetur gjë

22 tjetër veçse t'u përgjigjen parashtimeve nëse ato paraqiten.

23 Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk keni

1 asgjë çështje tjetër?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Siç thatë juve do të ketë
3 parashtime, përgjigje ndaj tyre, po asgjë tjetër shtesë nga
4 ne.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë po i
6 kthehem çështjeve të rregullit 130 për të cilët kemi pritur.

7 Ju keni vënë në dukje se keni ndërmend të parashtroi
8 dokumenta në bazë të mocionit 130. Të gjithë do ta bëni këtë?
9 Nëse po, do t'i bëni veç e veç apo do t'i përmbliidhni?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Të katër ekipet kanë synim të
11 paraqesin një rregull në bazë -- një parashtim në bazë të
12 rregullës 130 së bashku.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë s'kam
14 nevojë t'u lutem sepse ishte një nga gjërat për të bërë për ta
15 lehtësuar disi punën.

16 Ju keni thënë se ju duhet -- e lejon rregulli një
17 periudhë dhjetë ditore dhe ne thamë që nuk do të jemi strikt
18 lidhur me të. Ju thatë që ju nevojiten 30 ditë për t'u
19 përgatitur. Vazhdoni të keni të njëjtin mendim?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në diskutimet me ekipet e
21 Mbrojtjes duke pasur parasysh vëllimin e materialit si provë
22 që janë paraqitur nga ZPS-ja, qëndrimi ynë është se do të na
23 duhen 14 ditë nga data e vendimit të fundit të Trupit Gjykses
24 lidhur me provat e paraqitura nga Prokuroria. Nuk mund të
25 bëjmë një parashtim të rregullit 130 pa ditur, pa pasur një

1 ide të gjithë provave të paraqitura.

2 Pra, vendimi i fundit nga ana juaj, plus 14 ditë kërkojmë
3 që do të na jepte, do të çonte të themi në qershor, duke
4 supozuar që ju do t'u duhet një muaj për t'i zgjidhur të
5 gjitha këto çështje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe do të
7 ishit gati të vazhdonit nëse do ta bënim më herët?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo pastaj krijon -- na çon në një
9 çështje tjetër, po duam të paktën deri më 1 qershor. Mesa
10 kuptoj një nga përgjigjet tona duhet të jepet në 5 maj lidhur
11 me një nga mocionet jogore. Pastaj do të ketë kundërpërgjigje
12 nga Prokuroria.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj, e
14 kuptoj, do të duhet një kohë. E kuptoj kërkesën tuaj.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase do të paraqesim dokumentin
16 tonë nga mesi i qershorit në bazë të rregullit 130 në vartësi
17 të kohës që do t'ju duhej juve, si Trup Gjykses, të jepni
18 vendimin tuaj. Nëse ju do ta jepni më herët, mendojmë që
19 parashtrimi ynë do të ishte nga mesi i qershorit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka njeri
21 tjetër që do të shtojë lidhur me këtë nga Mbrojtja?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,
23 ne kërkojmë që mesi i qershorit të ishte koha kur duhet të
24 paraqesim parashtrimin tonë, duke pasur parasysh vëllimin e
25 materialit. Dhe ju thatë që 30 ditë janë një afat i arsyeshëm.

1 Pastaj duhet të presim për vendimin tuaj.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
3 ndonjë problem me afatin 30 ditor.

4 Po të dëgjojmë dhe ZPS-në në qoftë se ka ndonjë
5 kundërshtim Prokurori.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Neve e respektojmë mendimin e
7 Trupit Gjykses.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Përkthim] Nga ZPS-ja sa kohë ju duhet për t'u
10 përgjigjur?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kërkuam një zgjatje një muaj,
12 shtyrje të afatit. Nuk ndryshon kjo gjë. Dhe për procesverbal
13 ne duam të japim një përgjigje përmbledhëse.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne nuk e quajmë zgjatje apo
15 shtyrje të afatit sepse në kohën që i bëmë parashtimet nuk e
16 dinim që kishte kaq shumë material.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 [Përkthim] Nuk po e përdor këtë term për të treguar se
19 çfarë mendoj. Dua të them që është një afat më i gjatë se
20 ç'kishim menduar fillimisht.

21 Këtë gjë duhet ta diskutojmë pas takimit dhe nga fundi i
22 ditës do të japim vendim për të ditur të gjithë se ku jeni. Do
23 ta bëjmë, pra, këtu sot.

24 Për procesverbal rregullorja lejon të bëhet mocion dhe
25 një përgjigje dhe jopërgjigje. Do t'i përmbahemi kësaj. Ka një

1 dispozitë se mund të bëhen argumente me gojë. Ka njeri për të
2 bërë ndonjë argument, a dëshiron njeri të bëjë argument me
3 gojë pas dorëzimit të mocionit të rregullit 130. Në qoftë se
4 do ta bëni çfarë janë ato që nuk i vendosni dot në mocionin me
5 shkrim që kërkon ta bëni me gojë?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne kërkojmë të paraqesim argument
7 me gojë. Meqenëse nuk do e bëjmë kundërpërgjigje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ideja
9 është që nuk do të ketë kundërpërgjigje.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po meqenëse ekziston mundësia e
11 argumentit gojor ne nuk themi dot tani se çfarë argumenti me
12 gojë do të jetë paparë, se çfarë do të paraqesë Prokuroria.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ne jemi të gatshëm për çdo seancë
14 që mund të kërkohej.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo ka të bëjë të themi me --
16 afrohet me argumente përmbyllëse, kështu që në parashtrimet
17 gojore mund të ngrihen çështje që mund të dalin apo dhe t'i
18 përgjigjemi ndonjë pyetje që mund të keni ju si Trup Gjykses.

19 Pra, nuk është e njëjtë, është një moment i rëndësishëm
20 në çështjes, pra, argumentet gojore.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 [Përkthim] Ne duam që të vendosim një numër të caktuar
23 fjalësh për mocionet. Duam të dëgjojmë nga ju meqenëse ju do
24 të parashtroni të partë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Duke marrë parasysh faktin që do

1 të paraqesim parashtrim së bashku të gjithë, propozojmë të
2 jetë 20.000 fjalë. Secili nga ne ka të drejtë të paraqiste
3 6000 fjalë kështu që do të ishte 4000 fjalë më pak nga ç'na
4 takon.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigje?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë mendim. Ne
7 kërkojmë zgjatjen reciproke të fjalëve për përgjigjen tonë
8 përmbledhëse.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Pasi ta keni vënë në dukje se çfarë
10 -- sa fjalë duhet të ketë mocioni, atëherë do të kemi mundësi
11 që t'u kërkojmë një shtim të numrit të fjalëve në vartësi të
12 çështjeve që do të ngrihen, do të shqyrtohen pasi të
13 konsultohemi me klientët.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa thënë që
15 do ta përmbushim këtë, juve mund të bëni gjithmonë një
16 kërkesë, sigurisht që mund ta bëni një kërkesë të tillë.

17 Për procesverbal, nuk ka apel nga Mbrojtja nëse mocioni
18 130 do të refuzohet, dhe ju e dini këtë.

19 Tani dua të pyes Mbrojtësin e Viktimave, z. Laws. Duke
20 supozuar se një apo më shumë nga të akuzuarit, tani e dimë të
21 gjithë pra, në mënyrë të përmbledhur do të paraqesin mocion
22 sipas rregullit 130, ju do të paraqisni çështjen sa më shpejt
23 që të jetë e mundur pasi të jepet vendim për mocionet e
24 rregullës 130, dhe për ta bërë duhet të kemi paraprakisht disa
25 deklarata tuaja. Kur mendoni se mund të listoni dëshmitarët e

1 propozuar apo ndonjë raport apo materiale të tilla. E keni
2 fjalën --

3 Z. LAWS: [Përkthim] Pikësëpari ne kemi porositur dy
4 raporte ekspertë që trajtojnë çështjet, provat psikologjike,
5 psikiatrike, dhe tjetri jep disa shifra lidhur me dënim
6 material apo humbjet ekonomike të shkaktuara. Të dy raportet i
7 kemi marrë gjatë pushimit të Pashkëve. Njëri është në
8 holandisht dhe është dërguar për përkthim. Tjetri është në
9 anglisht.

10 Rrjedhimisht shpresojmë shumë që përkthimi të mos zgjasë
11 shumë dhe kemi mundësi që javën -- në fund të javës tjetër, më
12 2 maj, t'i paraqesim të dy raportet në bazë të rregullës
13 114(5).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.
15 Ne mendonim se ju do ta bënit këtë në 14 maj. Pra, kjo tregon
16 që do ta bëni.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Po, me kënaqësi do ta bëjmë më herët
18 nëse e marrim materialin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, mund ta
20 paraqisni, ta dorëzoni sapo ta keni në dorë. Besoj e quajmë
21 datën 14.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Po, padyshim.

23 Është dhe një temë tjetër e lidhur me të që të dy
24 ekspertët tek të cilët do të mbështetemi në Çështjen 06, kanë
25 dhënë raporte edhe në Çështjen 04 dhe 05, dhe ne synojmë që

1 t'i përdorim këto raporte të çështjeve të mëhershme duke pasur
2 parasysh, pra, atë që përmendët më herët. Nuk e di nëse kjo
3 kërkon ndonjë parashtrim shtesë. Synojmë ta bëjmë këtë deri në
4 14 maj. Edhe këto do ta bëjmë deri në 14 maj.

5 Pastaj mbetet aspektet e tjera të çështjes. Kemi parasysh
6 paragrafin 72 të Urdhrit për Ecurinë e Procesit dhe udhëzohen
7 palët dhe pjesëmarrësit që të paraqiten -- paraqesin çështjen
8 e tyre në mënyrë kronologjike -- logjike dhe t'ju njoftojmë
9 juve si Trup Gjykues për mënyrën si do t'i paraqesim provat.
10 Këtë gjë mund ta bëjmë gjithashtu në 14 maj -- deri në 14 maj
11 ku do të paraqesim udhëzuesin për mënyrën sesi do t'i
12 paraqesim çështjet, çfarë parashtrimet do të bëjmë dhe temat
13 që do të trajtojmë. Dhe besoj nuk ka nevojë që të futem në
14 hollësi sot. Por, janë disa, pra, çështje dhe me kënaqësi mund
15 t'ju japim indikacion të këtyre gjërave deri në 14 maj.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtu
17 përfshini dhe listën e provave materiale, z. Laws?

18 Z. LAWS: [Përkthim] Kemi parasysh këtë që të parashtrojmë
19 një mocion jogojor pas 14 majit. Ky është një nga mocionet që
20 kemi parasysh. Së fundi, do t'ju japim një listë të provave
21 materiale, po jo deri në 14 maj.

22 Së fundi, për këtë aspekt, pra, statusit të përgatitjeve,
23 propozojmë që të dorëzojmë një kërkesë për të thirrur
24 dëshmitarë të tjerë ose për të bërë kërkesë sipas rregullit
25 153 deri 155, dhe do të kërkojmë pak më vonë se 14 maji ta

1 bëjmë këtë në qoftë se na lejoni. Duam ta bëjmë në 28 maj këtë
2 gjë. Pra, këto janë çështjet të cilat do të parashtrojmë.

3 Me qëllim që Trupi Gjykses dhe Mbrojtja të mos kenë
4 ndonjë dyshim, kur flas për thirrjen e dëshmitarëve dhe
5 paraqitjen e një kërkesë deri më 28 maj për të thirrur
6 dëshmitarë, nuk përfshij këtu dokumente që i kemi përgatitur
7 për viktimat të cilat janë në fakt deklarata apo informacion
8 shtesë për dënim e shkaktuar viktimave të cilat do t'i
9 përshkruajmë me hollësi të plotë në parashttrimet tona deri në
10 14 maj. Por kjo është një kategori e veçantë e materialit që
11 nuk do të përfshijë thirrjen e dëshmitarëve për të dëshmuar
12 drejtpërdrejtë, por shpresojmë të ofrojmë informacion shtesë
13 lidhur me dënimin e shkaktuar të një numri shumë të madh
14 viktimash në këtë çështje. Dhe ky është një parashttrim që ne
15 mendojmë se do ta bëjmë mjaft më vonë majit, më vonë se maji,
16 por që është pjesë e çështjes sonë të vartësi të mënyrës se si
17 do të zhvillohet procesi deri përpara pushimit të verës apo më
18 pas.

19 Presim që këtë material ta dorëzojmë rreth asaj kohe.

20 Pra, këto janë çështjet që dëshiroja të ngrija lidhur me
21 paraqitjen e provave nga ana jone dhe ç'ka kemi ndërmend të
22 bëj. Duhet të përmend gjithashtu se ekspertët që ne presim të
23 dëshmojnë, në vartësi të miratimit tuaj, janë ekspertë që
24 lidhen me provat psikologjike, psikiatrike që ne presim të
25 bëhen nga dëshmitarë drejtpërdrejtë. Disponueshmëria e tyre

1 është e kufizuar. Nuk janë të gatshëm të vijnë kur të duam ne,
2 si të thuash. Ne i kemi kontaktuar, kemi folur me ta për data,
3 kanë përmendur 7 dhe 14 qershorin si data kur mund të jenë të
4 disponueshëm. Kjo nuk do të thotë që patjetër do të ndodhë
5 kështu, prandaj po e ngre tani këtë çështje. Pra, mbase një
6 javë pas 21-shit do të ishte e pamundur për ta, kështu që ju
7 të keni një ide të plotë se ku ndodhemi.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
9 vlerësim më të mirë se sa ditë do të kërkojë kjo në seanca
10 këtu në gjykatë?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk mund të them dot. Nuk mund të
12 them se s'do të vazhdojë deri javën e dytë. Do të thërrasim
13 dëshminë, pra, psikologjike që mund të duhet më shumë se një
14 ditë për ta paraqitur, në vartësi të faktit nëse ka viktimë që
15 dëshirojnë të dëshmojnë drejtpërdrejtë në përputhjet me datat
16 që ju kam dhënë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam nja dy pyetje për ju,
18 z. Laws, që ta kuptoj si duhet atë që thatë. A jeni duke thënë
19 se do të kishit vështirësi për të na dhënë një listë të
20 dëshmitarëve të propozuar dhe të provave përkatëse deri në 14
21 maj dhe se këto lista janë tentative? Pra, ju kuptova drejt se
22 nuk e bëni dot këtë gjë deri në atë datë?

23 Z. LAWS: [Përkthim] Lidhur me vënien në dukje të
24 dëshmitarëve përkatëse kemi sugjeruar një datë të mëvonshme
25 për parashtrimin, ku të paraqesim dëshmitarët që kemi ndërmend

1 t'i thërresim bashkë me ekspertët dhe kërkesa nëse do të na
2 duhet të bëjmë, sipas rregullës 153, 155. Ne kemi propozuar
3 datën 28 maj për këtë gjë, në atë moment mendoj që do të ishim
4 në gjendje të jepnim listën e dëshmitarëve dhe provave
5 materiale.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani do t'ju
7 bëj një pyetje që ka të bëjë me aspektet e tjera. Pasi të
8 bëhet njoftimi palët do të kenë nevojë që të përgatiten për
9 provat tuaja, për dëshmitarët që do të thërrisni, në qoftë se
10 do vendosni që t'i thërrisni ata. Thjesht dua t'ju pyes në
11 qoftë se jeni përfshirë në diskutime me Mbrojtjen dhe ZPS-në
12 sa i takon provave tuaja, dëshmitarëve që do të thërrisni duke
13 marrë parasysh këtu parashikimin e kundërshtimit që mund të
14 ketë, në qoftë se mund të shprehem kështu, nga palët. Nuk ju
15 kërkoj hollësi të tjera, po thjesht do të doja të dija në
16 përgjithësi në qoftë se keni patur ndërveprime me palët,
17 thjesht për të krijuar një ide se sa kohë mund të duhet për
18 paraqitjen e provave të Mbrojtësit të Viktimave.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Unë kam bërë biseda me z. Misetic, që
20 është përfaqësuesi i Mbrojtjes së z. Thaçi dhe i ekipeve të
21 tjera të Mbrojtjes dhe kemi diskutuar për fusha sa i takon
22 dëshmisë së dëshmitarëve ekspertë. I kam thënë z. Misetic, e
23 kemi pasur këtë bisedë me të dhe nuk më takon mua që t'i
24 kërkoj atij apo askujt tjetër nga ekipet e Mbrojtjes që të
25 pajtohet paraprakisht me faktin që ato janë dakord apo jo që

1 këto të jenë dëshmitarët e Mbrojtësit të Viktimave.

2 Megjithatë, deri tani, deri në këtë pikë, sa i takon
3 individëve që janë viktima konkretë ne nuk kemi bërë biseda,
4 nuk kemi bërë diskutime me ekipet e Mbrojtjes sepse nuk e kemi
5 përfunduar akoma listën e personave që do të vijnë dhe do të
6 japin dëshmi këtu, dhe pjesërisht për këtë arsye ne kërkuam
7 shtyrje të afatit në maj. Dhe dua t'ju them që ka më shumë se
8 100 persona në kategorinë e viktimave që nuk kanë dhënë
9 dëshmi, por që mund të jenë dëshmitarë potencialë. Kështu që
10 bisedat lidhur me këtë temë janë në vijim e sipër e për këtë
11 arsye ne nuk është se kemi një ide konkrete lidhur me këtë
12 kategori dëshmitarësh.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e dini se
14 kur jeni gati që të paraqisni provat jогоjore?

15 Z. LAWS: [Përkthim] Kjo është një nga mocionet që unë
16 sugjerova që të përfshihej në parashtrimin që ju, të nderuar
17 Gjykatës, thatë që do ishte mirë që të dorëzohej deri me 14
18 maj. Megjithatë, nuk është parashtrim thelbësor, bëhet fjalë
19 vetëm thjesht për disa dokumente të cilat ne duam që t'ja
20 paraqesim Trupit Gjykues deri në atë afat kohor. Megjithatë,
21 nëse caktohet një datë sot për ta bërë këtë gjë, nuk ka
22 problem fare prej nesh. Data 14 maj duket datë e arsyeshme, në
23 qoftë se doni që të caktojmë ose ndoshta edhe pas një jave pas
24 14 majit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha

1 dëshmitë shkresore do vendosen -- do kërkojnë që të vendosen
2 prej jush përmes mocionit të provave jогоjore, apo mendoni që
3 disa prej tyre do të pranohen ndryshe?

4 Z. LAWS: [Përkthim] Disa prej tyre do kërkojnë që të
5 pranohen mbështetur në parashikimet e rregullës 153.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë, në
7 qoftë se ne do të marrim si bazë datat që u sugjeruan nga
8 Mbrojtja, që jo domosdoshmërisht u pranuan nga ZPS-ja, por që
9 ZPS-ja deri tha që nuk është se ka ndonjë kundërshtim lidhur
10 me to, i takon që ju do të duhet të përgjigjeni diku përpara
11 pushimit të verës të Gjykatës dhe ndoshta ky nuk është një
12 afat shumë i mirë. Dhe fakti që ju keni një ose dy -- nuk keni
13 një ose dy dëshmitarë të disponueshëm, a do ishte e drejtë të
14 thuhej që në qoftë se ne i pranojmë datat e Mbrojtjes, ju do
15 jeni gati që të filloni me dëshmitarët tuaj pas pushimit të
16 verës të Gjykatës?

17 Z. LAWS: [Përkthim] Atëherë, në qoftë se Mbrojtja do
18 përgjigjet deri 30 ditë pas mesit të qershorit dhe më pas
19 Prokuroria do të përgjigjet 30 ditë pas kësaj periudhe, i
20 takon që do të duhet edhe kohë edhe për vendimin prej anës
21 tuaj. Kështu që në përgjigje të pyetjes tuaj ne do të
22 preferonim që të kishim një datë të përcaktuar prej jush tani
23 dhe të punonim mbi bazën e asaj, sesa të përcaktonim datë më
24 vonë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë

1 arsyë ja u bëmë këtë pyetje. Edhe ne pajtohemi ju lidhur me
2 këtë. Mendojmë që sa më shpejtë të përcaktojmë disa data, aq
3 më mirë do të jetë për të gjithë, dhe të gjithë do të përpiqen
4 që ti respektojnë ato.

5 A ka pyetje të tjera për z. Laws?

6 Faleminderit, z. Laws.

7 Z. LAWS: [Nuk ka përkthim].

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja që të komentoja të
9 paktën ne të Mbrojtjes së z. Thaçi.

10 Nga qëndrimi ynë z. Laws ka të drejtë, në fakt e tha me
11 qartësi se çfarë bisedash kemi pasur ne. Por, deri sot në
12 mëngjes ne nuk kemi qenë të informuar dhe fakti që, për
13 shembull, do të ketë një mocion jогоjor që do të paraqitet dhe
14 mocione të tjera të cilat do të kenë të bëjnë me dëshmitarë të
15 tjerë të mundshëm shtesë. Kështu që do ishte me vlerë për
16 përgatitjen e ekipeve të Mbrojtjes në qoftë se ne do të
17 fillojmë me dëshmitarët e Mbrojtësit të Viktimave pas pushimit
18 të verës që Gjykatës. Të gjithë shpresonim që do ta kishim
19 përfunduar mbrojtjen e -- dëshmitarëve të Mbrojtjes së
20 Viktimave përpara pushimi, megjithatë mendoj që do të ishte më
21 mirë që të përcaktonim kohën pas pushimit të Gjykatës për
22 fillimin e çështjes së Mbrojtësit të Viktimave.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Edhe unë i bashkohet qëndrimit të z.
24 Misetic. Dëshiroj që të theksoj gjithashtu ashtu çfarë u
25 nënkuptua prej disa prej pyetjeve të Gjykatësit Metttraux se

1 nevojitet kohë për përgatitjen nga palët për sa i takon
2 dëshmitarëve të Mbrojtësit të Viktimave. Jo vetëm kaq, por
3 varet dhe nga numri i dëshmitarëve që do të thërrasë z. Law.
4 Kështu që është mirë që të jepen njoftime edhe në qoftë se ato
5 janë paraprake sepse të paktën kjo mund të na parapërgatitë
6 ne, dhe ne mund të fillojmë punën tonë. Dhe në qoftë se disa
7 dëshmitarë, për shembull, do të vendoset në momentin e fundit
8 që të mos vijnë, nuk është se ka problem, po do të ishte mirë
9 që të kishim njoftime paraprake për t'u përgatitur siç duhet.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj
11 kërkesën tuaj. E kuptoj që ju duhet të keni sa më shumë
12 informacion që të jetë e mundur. Për këtë arsye unë gjithmonë
13 e më tepër ju bëj pyetje juve se çfarë lloj mbrojtje do bëni,
14 në veçanti duke marrë parasysh afatin kohor për të pasur një
15 ide domethënë. Në qoftë se ne e dimë që do na duhet një muaj
16 ose dy muaj për të dëgjuar dëshmitarët e ekipeve të mbrojtjes
17 kjo do të na ndihmonte për përgatitje, kështu që edhe një herë
18 do ju kërkonim që ta mendonit këtë se do ta ndihmonit shumë
19 për arsye kalendari ose planifikimi. Për ne nuk është fare e
20 rëndësishme se kë do thërrisni ju si dëshmitarë ose sa
21 dëshmitarë do keni apo çfarë do paraqisni sa i takon provave
22 shkresore, por, për ne do ishte mirë që të kemi një afat kohor
23 për të qenë më mirë të përgatitur për planifikime, thjesht për
24 të pasur idenë se sa kohë do të na duhet për dëshmitarët tuaj.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Neve ja u kemi dhënë përgjigjen më

1 përpara. Ne e keni bërë këtë pyetje edhe më përpara. Kam
2 përshtypjen që Gjykatësi Gaynor ma ka bërë këtë pyetje muaj më
3 përpara, por ne nuk është se -- nuk e dimë se saktësi. Unë kam
4 thënë që ne do kemi deri në dhjetë dëshmitarë, megjithatë nuk
5 mund t'jua themi këtë gjë me siguri.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di, ky
7 është numri i dëshmitarëve të ekipit të Thaçit apo për të
8 gjitha ekipet e Mbrojtjes.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, kjo është vetëm për Mbrojtjen
10 e z. Thaçi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju të
12 tjerët keni ndonjë ide? Atëherë nuk dua t'ju bë në pozitë të
13 vështirë, thjesht dua të kem një ide sa i takon kohës.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam mundësi
15 t'ju them më shumë sesa ju kam thënë përpara, se është një
16 situatë të cilën po e analizojmë ende. Megjithatë, ajo çfarë
17 mund të them unë tani është që duhet që të konsultohemi si
18 ekipe mbrojtëse në mënyrë të tillë që të mund t'ju japim një
19 afat të përgjithshëm për katër ekipet e Mbrojtjes sa i takon
20 dëshmitarëve tonë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dua t'ju
22 -- nuk ja u kërkoj tani për momentin tani, por gjithsesi do të
23 doja që të kishim një ide më të qartë.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Do planifikojmë më tej dhe do t'ju
25 japim informacion kur të kemi më shumë informacion më të

1 qartë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon
3 Mbrojtjes së Viktimave, neve inkurajojmë biseda *inter partes*
4 sa i takon këtyre çështjeve, në veçanti lidhur me dokumentet
5 që do kërkonin që të pranohen, sepse mund të ndodhë që procesi
6 të jetë shumë më i shpejtë sesa mendojmë ne që të jetë në
7 qoftë se palët nuk kanë kundërshtime të mëdha lidhur me
8 dokumentet.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Po, patjetër.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe për
11 Prokurorinë vlen i njëjti koment edhe për ekipet e Mbrojtjes.
12 Duhet të jeni sa më të hapur që të jetë e mundur. Pra, në këtë
13 pikë do të jetë me vlerë, do të ishte mirë që të kemi
14 diskutime dhe të ketë bashkëbisedime midis palëve.

15 Pjesa tjetër e pikave që kam në rendin e ditës për sot
16 kanë të bëjnë me kalendarin për konferencën për Mbrojtjen, për
17 Ecurinë e Çështjes, domethënë për provat e Mbrojtjes.
18 Megjithatë ndoshta është e parakohshme për të diskutuar sot
19 sepse sa i takon rregullores, rregulloja është shumë konkrete
20 sa i takon asaj çfarë duhet të ndodhë dhe hapave të ndryshëm
21 proceduralë që do të duhet që të përmbushen, kështu që të
22 gjitha ekipet duhet të jenë të gatshme dhe duhet të
23 respektojnë rregullat që janë parashikuar për këtë.

24 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon, ju

1 e ngritët këtë çështje përpara një çasti.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja që
4 kemi për ju është kjo: Kur diskutoni aspektet e kohës a mund
5 të na jepni një ide se kur mund të keni më shumë informacion
6 të hollësishëm lidhur me dëshmitarët që do të thërrisni?

7 Z. DIXON: [Përkthim] E keni fjalën për kohëzgjatjen, për
8 sa do zgjasë?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Dhe po ju
10 pyesim se kur jeni gati që të na jepni këtë informacion. Kur
11 do na e bëni me dije këtë informacion.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Pra, kemi dy periudha kohore: e
13 para, në fakt, do jetë diçka të cilën mund t'jua japim shumë
14 shpejt, por ndërkohë informacion ka të bëjë me pikën e dytë ne
15 do të mundohemi t'jua japim në një moment të përshtatshëm se
16 dhe sa më shpejt të jetë e mundur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do na
18 ndihmonit.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Po, do ta konsideroj këtë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do na
21 ndihmonit shumë dhe e dimë që ju po punoni lidhur me këtë.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po, absolutisht po.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po jepen
24 deklarata për shtyp, për shembull, se kur do të dorëzohen
25 mocioni sipas rregullës 130 apo kur do të thërriten

1 dëshmitarët edhe për këtë arsye ne jemi kuriozë dhe duam të
2 dimë se çfarë do të ndodhë më tej, të paktën të kemi një
3 informacion paraprak.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Unë nuk kam bërë ndonjë deklaratë.
5 Këto janë çështje të cilat ne i kemi diskutuar brenda për
6 brenda nesh, megjithatë do kem mundësi që t'ju përgjigjem sa
7 më shpejt që të jetë e mundur sipas afateve kohore të
8 përcaktuara.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë
10 faleminderit.

11 Megjithatë, nuk dua ta përfundoj këtë konferencë, këtë
12 takim pa theksuar për të gjitha palët që keni qenë
13 jashtëzakonisht bashkëpunues dhe e di që shpesh herë kjo nuk
14 është e thjeshtë, e di që është një çështje e vështirë, e di
15 që bëhet fjalë për dëshmitarë të cilët janë të vështirë për
16 prova materiale të vështira, të komplikuar, megjithatë të
17 gjitha palët janë munduar që të respektojnë sugjerimet që janë
18 bërë dhe premtimet që janë bërë dhe ju vlerësojmë shumë për
19 bashkëpunimin. Ne nuk ju kritikojmë gjatë gjithë kohës. E dimë
20 se sa e vështirë është prej jush që një çështje e këtij
21 dimensionit të përfundojë sipas afateve të përcaktuara. Në
22 veçanti e kam fjalën këtu për dëshmitarët e Prokurorisë dhe në
23 fakt që janë dashur përpjekjet e të gjitha palëve që të jemi
24 këtu sot. Nuk është vetëm thjesht punë e Prokurorisë por është
25 punë e përbashkët e të gjitha ekipeve, kështu që e vlerësojmë

1 shumë gjithë punën e bërë prej të gjitha palëve.

2 Nuk dua të harroj diçka që kam shënuar.

3 Ka disa shënime. Atëherë duam që të konfirmojmë dhe një
4 herë që në këtë pikë nuk synojmë që të thërrasim dëshmitarë
5 ose që të dorëzojmë dokumente nga ne, pra nga Trupi Gjykses. E
6 kuptojmë që gjërat mund të ndryshojnë, megjithatë për momentin
7 ne nuk synojmë ta bëjmë këtë gjë siç janë zhvillimet deri
8 tani.

9 Një tjetër gjë që dua t'ju them, përderisa ju të gjitha,
10 pra, ekipet e Mbrojtjes kanë dhënë një deklaratë hapëse në
11 fillim të prillit të 2023-shit në fillim të çështjes gjyqësore
12 ne nuk presim që të bëhet një deklaratë hapëse shtesë përpara
13 prezantimit të provave të ekipeve të Mbrojtjes, sepse juve
14 deklaratat hapëse i keni bërë në fillim të procesit gjyqësor.

15 A ka ndonjë çështje të fundit, ka ndonjë diskutim tjetër
16 që dëshironi të na sillni në vëmendje?

17 Z. TULLY: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, bëhet fjalë
18 për një aspekt që u ngrit nga z. Selimi. Z. Selimi e ka pasur
19 të vështirë që të kontaktojë botën e jashtme, domethënë botën
20 përtej burgut, në veçanti familjen e tij. Besojmë që kjo
21 lidhet me kushtet e ndryshuara të paraburgimit të cilat unë
22 nuk do i shtjelloj në hollësi këtu, megjithatë për Trupin
23 Gjykses dëshiroj që të sillni në vëmendje mocionin e dorëzuar
24 me 13 dhjetor 2024, që është parashtimi F02785. Ne kemi marrë
25 përgjigje, jemi përgjigjur sa i takon pretendimeve dhe

1 konstatimeve të bëra nga Mbrojtësi i Viktimave.

2 Ne e dimë se si janë kushtet dhe çfarë ndikimi kanë këto
3 kushte mbi jetën e z. Selimi. Ne parashtrojmë që kushtet e
4 përcaktuara nuk janë më proporcionale dhe nuk janë më, dhe nuk
5 janë më të domosdoshme.

6 Kështu që për këtë arsye ne, me respekt ju kërkojmë
7 udhëzim juve, pra Trupit Gjykues se kur duhet të presim që të
8 merret një vendim lidhur me këtë aspekt.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'jua
10 japim sot edhe këtë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam dy pika. Pika e parë, sepse
12 dua që të informoheni plotësisht përpara sesa të merrni një
13 vendim, e kam fjalën për një prej pikave që ne diskutuam pak
14 më përpara për mocionin *in limine*. Për mocionin *in limine* ne
15 na duhet një kërkesë që shkon përtej sesa 12 fjalë dhe --
16 12.000 dhe gjithashtu dëshirojmë që të bëhet një shtim i
17 numrit të fjalëve për mocionin *in limine* dhe gjithashtu dhe
18 një zgjatje të afatit. Domethënë, në qoftë se ju na detyroni
19 që t'i përgjigjemi mocionit të ZPS-së deri më 8 maj, kërkojmë
20 që të bëhet shtyrja e afatit dhe shtimi i numrit të fjalëve.

21 Pika ose aspekti i dytë është që z. Thaçi me respekt
22 kërkon që diskutimet e seancës të mund t'i ndjekë përmes
23 videolidhjes për pjesën e dytë të konferencës.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull. Atëherë thjesht kam dy
25 aspekte shkurtra. Jemi drejt fundit të rendit të ditës, por

1 kërkesa jonë ka të bëjë me problemin e vazhdueshëm të z.
2 Veseli për të paktën muajt e fundit, tre muaj e fundit për të
3 pasur mundësi për të folur me fëmijët e tij përmes telefonit.
4 Z. Veseli e ka të vështirë që të komunikojë me ta përmes
5 telefonit sepse ka ndërprerje të vazhdueshme.

6 Fatmirësisht ne kemi marrë një përgjigje të hollësishme
7 prej Zyrës Administrative lidhur me këtë aspekt përpara sesa
8 të fillojmë seancën. Kemi gjetur një zgjidhje të ndërmjetme
9 dhe Zyra Administrative po punon për ta zgjidhur këtë çështje.
10 Megjithatë, dëshirojmë që të theksojmë që z. Veseli mban
11 qëndrimin që situata është e papranueshme, që kanë ndërhyrë me
12 të drejtat e tij, dhe që ka pasur ndikim gjithashtu edhe në
13 përgatitjen e çështjes apo provave të Mbrojtjes. Për këtë
14 arsye thjesht donim t'jua sillnim në vëmendje. Do të
15 kontaktojmë me ju, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses por
16 gjithashtu edhe Zyrën Administrative.

17 Nuk është e nevojshme që ta diskutojmë sot më tej këtë
18 aspekt, megjithatë dëshironim t'ju sillnim në vëmendje.

19 Ndërkohë që elementi i dytë, ose aspekti i dytë ka të
20 bëjë me vizitat në paraburgim dhe takimi i personave me z.
21 Veseli. Ky është një aspekt të cilin e kanë si problem dhe
22 ekipet e tjera të Mbrojtjes, megjithatë nuk dua që të futem në
23 hollësi, por dëshiroj të them që ne duam të sigurojmë që të
24 jemi në gjendje të kemi njoftim paraprak mjaftueshëmrisht për
25 sa i takon konfirmimit të vizitave në mënyrë të tillë që të

1 mos presim deri në momentin e fundit, sepse këto kanë ndikim
2 mbi aspektet logjistike, mbi organizimin e planifikimit e të
3 tjerë.

4 Sigurisht ky është një aspekt të cilin e kemi ngritur me
5 Zyrën Administrative, por dëshironim t'ja u vinim edhe juve në
6 vëmendje. Pra, ndoshta do të ishte mirë që ju të vendosni dhe
7 të jepni një udhëzim të qartë që konfirmimi i vizitave të
8 jepet sa më shpejt të jetë e mundur. Ne kemi kërkuar që
9 konfirmimi të bëhet dhjetë ditë para vizitës, në mënyrë të
10 tillë që të bëhen organizimet e nevojshme. Tani është shumë e
11 rëndësishme për neve që të kemi kontakt me klientë, sepse
12 klientët nuk janë në gjykatë gjatë të gjithë kohës, sepse
13 duhet që të diskutojmë për provat e ekipeve tona për
14 dëshmitarët që do të thërrasim e çështje të tjera të
15 rëndësishme.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht dua t'ju vë në dijeni ju,
17 anëtarë të Trupit Gjykses, që të njëjtin problem e ka dhe z.
18 Thaçi sa i takon biseda telefonike me të shoqen dhe me djalin
19 e tij. Këtë doja që ta bëja të qartë për procesverbal.

20 Ndërkohë që pika e dytë ka të bëjë me një problem që kam
21 pasur për t'u takuar me z. Thaçi dje dhe dje Zyra
22 Administrative, z. Nilsson ndërhyri menjëherë në mënyrë që të
23 zgjidhej problemi.

24 Dhe dua të falënderoj z. Nilsson dhe zyrën e tij për
25 ndërhyrjen e menjëhershme dhe për gjetjen e zgjidhjes së atij

1 problemi.

2 Ne nuk dimë se çfarë problemesh ka njësia e paraburgimit
3 për organizimin e vizita, megjithatë dëshiroj të them që për
4 aq kohë sa mund të bashkëbisedojmë dhe të dimë se cilat janë
5 problemet, mendojmë që të gjithë mund të kontribuojmë për
6 lehtësimin dhe realizimin e këtyre vizitave. Ne jemi të
7 gatshëm për të dhënë kontributin tonë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jonas, po
9 juve keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me këtë?

10 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
11 Atëherë, do më pëlqente shumë ta merrja unë të gjithë meritën
12 për zgjidhjen e dhënë dje, por e vërteta është që problemi i
13 djeshëm u zgjidh pa përfshirjen time konkretisht. Do mundohem
14 t'jua shpjegoj me pak fjalë se çfarë ndodhi.

15 Po flasim për çështje të disponueshmërisë së dhomave të
16 vizitave. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me ekipet e
17 Mbrojtjes në mënyrë të tillë që të realizojnë ekipet --
18 domethënë, vizitat e ekipeve të Mbrojtjes dhe që të bëjmë
19 koordinimin e të gjitha vizitave që bëhen për të ndaluarit.

20 Ka një numër të kufizuar të dhomave që përdoren për
21 vizita dhe ne po i përdorim ato në maksimum. Megjithatë duhet
22 të merret parasysh edhe mjedisi i sigurisë dhe ka shumë punë
23 prapaskena që kërkohet që të gjitha kërkesat, pra, respektohen
24 sa më shumë të jetë e mundur, që bëhet një shpërndarje e
25 drejtë e dhomave, bëhet gjithashtu edhe një shpërndarje e

1 drejtë e burimeve të disponueshme dhe kjo bëhet jo vetë për të
2 akuzuarit në këtë çështje gjyqësore por për të gjithë personat
3 e ndaluar aty. Stafi në Njësinë e Paraburgimit bëjnë të
4 pamundurën në mënyrë të tillë që të gjejnë zgjidhje kreative
5 brenda kuadrit të mundshëm në kuadrin e sigurisë.

6 Megjithatë, pavarësisht kësaj ka disa raste ku neve
7 kërkojmë ndihmë nga tribunale të tjerë për të përdorur dhomat
8 e tyre të vizitave, siç ishte rasti i djeshëm, për shembull.
9 Për shembull, ndonjëherë neve na thonë tribunale të tillë që
10 domethënë nuk është e mundur që të përdoren dhomat e tyre të
11 vizitave deri në momentin kur janë absolutisht të sigurt që
12 nuk ka kërkesë për përdorimin e atyre dhomave siç ndodhi dje.
13 Pra, ne kur shohim që të gjitha dhomat e vizitave në pjesën
14 tonë të godinës janë të mbushura, mundohemi që të gjejmë
15 zgjidhje të tjera.

16 Po ashtu ne mundohemi që të ofrojmë dhe opsione të tjera
17 që nuk janë opsionet e preferuara nga ekipet e Mbrojtjes, si
18 për shembull takimet përmes videokonferencave ose takime që
19 mund të ndodhen dhe në këtë ndërtesë sot.

20 Përderisa kjo është një çështje e cila është ngritur disa
21 herë, unë kam parë procesverbalin e muajve të fundit për disa
22 prej ekipet e Mbrojtjes dhe raste konkrete kam parë që në
23 pjesën dërmuese thuajse gjithmonë ne ja kemi dalë që të gjejmë
24 një zgjidhje për të përmbushur kërkesën e ekipeve përkatëse.
25 Ndonjëherë mund të ketë njoftim në një afat të shkurtër,

1 ndoshta jo njoftim aq të shkurtër sa ishte dje, zakonisht
2 domethënë japim njoftim brenda pak ditësh. Megjithatë, duhet
3 të dini që ne kemi nevojë që të bëjmë koordinimet tona. Do
4 t'ju kërkonim ekipeve të Mbrojtjes që kishin pak durim, në
5 mënyrë të tillë që të trajtonim kërkesat e tyre sa më mirë që
6 të jetë e mundur.

7 Kaq kisha për të thënë. Ju falënderoj.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase mund të
9 bëni një takim të përbashkët, mbase takohen avokatët kryesorë
10 me Zyrën Administrative, me Jonasin, që të kuptoni problemin.
11 Ta keni parasysh, duhet t'i kërkojmë, për shembull, hua një
12 ambient ICC, Tribunali Penal Ndërkombëtar. Tribunali
13 Ndërkombëtar Penal nuk jep dot përgjigje sepse nuk e di a do
14 ketë të lirë sallën e vizitave. Kështu që është e vështirë që
15 t'ju japim përgjigje përfundimtare sepse ata nuk e dinë nëse
16 salla e tyre vizitave apo dhoma e tyre e vizitave do të jetë e
17 lirë ditën e caktuar. Pra, dhe një herë ju sugjeroj, ju lutem,
18 avokatëve kryesorë ta diskutoni këtë me Jonasin dhe me zyrën e
19 tij, me stafin e tij.

20 Unë besoj se e kam të qartë problemin vetë. Ne s'e
21 zgjidhim dot. S'e menaxhoj unë objektin e paraburgimit. Ne
22 mund të bëjmë ç'është e mundshme për ta zgjidhur që dhe ju të
23 keni mundësi të takoni klientët tuaj, por ama ekzistojnë disa
24 kufizime të cilat nuk janë në dorën tonë.

25 Besoj se një takim i përbashkët me Jonasin do ishte një

1 ide shumë e mirë, sidomos tani që kemi kohë të lirë plot,
2 sepse ju tani nuk keni nevojë të kontaktoni në mënyrë të
3 përditshme klientët tuaj. Edhe jam i sigurt që Jonas do të
4 bëjë të pamundurën për t'ju ndihmuar.

5 Faleminderit për komentet.

6 Ka diçka tjetër?

7 Z. ROBERTS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, kam unë
8 diçka për të thënë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.
10 Roberts.

11 Z. ROBERTS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Thjesht
12 fillimisht doja të flisja për t'ju treguar që ju kam ndjekur
13 këto dy orë, por ka dhe një kërkesë që kam bërë unë për shtim
14 afati për t'iu përgjigjur një mocioni për prova jогоjore.
15 Bëhet fjalë për materialin F3114. Avokati i z. Thaçi kërkoi
16 shtyrje të afatit deri më 5 maj dhe nuk u kundërshtua kjo nga
17 Prokuroria, dhe kërkesa është dorëzuar më 17 prill. Desha të
18 pyesja Trupin Gjykues nëse vlen kjo dhe për ne dhe nëse mund
19 të autorizohet dhe për ne që të përgjigjemi brenda 5 majit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, jua
21 miratoj shtimin -- zgjatjen e afatit edhe ky do të jetë afati
22 juaj përfundimtar.

23 Z. ROBERTS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju
24 faleminderit.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe një pikë të vogël. Megjithatë

1 do të kthehemi prapë në orën 2.30 apo jo?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] A është e mundshme të takohemi pak
4 më përpara para orës 2.30. Do e vlerësonim, para orës 2.30.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 [Përkthim] Në rregull. Në orën 2.00 atëherë, rifillojmë
7 në orën 2.00 sepse do të duhet të japim disa urdhra me gojë.

8 Edhe ja do keni shansin të më dëgjoni të lexoj prapë urdhra me
9 gojë tani prapë.

10 Në rregull. Bëjmë pushim deri në orën 2.00

11 --- Pauza e drekës fillon në orën 11.49

12 --- Seanca rifillon në orën 14.01

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
14 jap urdhrat që kanë mbetur, Trupi Gjykses njofton palët dhe
15 pjesëmarrësit që në këtë fazë nuk ka plan që të caktojë një
16 seancë dëgjimore në kuadër të litigimeve sipas rregullës 130.

17 I lutemi Mbrojtësit të Viktimave që të jetë gati për të
18 paraqitur provat e veta në muajin korrik.

19 Sa i takon kërkesës së Selimit lidhur me dokumentin
20 F02785, Trupi Gjykses po punon lidhur me këtë aspekt dhe do të
21 nxjerrim një vendim sa më shpejt që të jetë e mundshme. Trupi
22 Gjykses fton mbrojtjen të koordinojë me personat përgjegjës
23 brena Zyrës Administrative që të zgjidhni problematikat që
24 janë me këto telefonatat me të afërmit.

25 Kam disa urdhra me gojë tani.

1 Fillimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë
2 mocionin e përbashkët sipas rregullës 130 të hënën, 2 qershor
3 2025, ose brenda 14 ditësh pas vendimit të fundit të Trupit
4 Gjykses për pranimin e provave, cilado qoftë e fundit. ZPS-ja
5 urdhërohet të dorëzojë përgjigjen e konsoliduar përmbledhëse,
6 pra, deri të martën, 1 korrik 2025, ose brenda 30 ditësh nga
7 mocioni i Mbrojtjes sipas rregullës 130, cilado të jetë më e
8 fundit. Si përcaktohet në rregullën 130(2), nuk do të
9 shqyrtohen kundërpërgjigje.

10 Sa i takon shtimit të numrit të fjalëve, Trupi Gjykses
11 është bindur se janë treguar arsye të vlefshme për shtimin e
12 numrit të fjalëve për mocionin e përbashkët të Mbrojtjes sipas
13 rregullës 130 edhe përgjigjen përmbledhëse të ZPS-së. Në bazë
14 të nenit 36 të direktivës për parashtrimet e protokolluara dhe
15 dosjet, Trupi Gjykses miraton shtimin e numrit të fjalëve për
16 mocionin e përbashkët të Mbrojtjes sipas rregullës 130, pra, e
17 shton me 20.000, ndërsa përgjigjes së ZPS-së ia shton numrin e
18 fjalëve po ashtu me 20.000 fjalë. Por ju lutem palëve që të
19 bëjnë parashtrime që lidhen me debate juridike sipas rregullës
20 130.

21 Me këtë mbyll urdhrin e dhjetë me gojë.

22 Urdhri i njëmbëdhjetë me gojë që është afati i viktimave.

23 Urdhëroj Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojë jo më vonë se
24 të mërkurën, 28 maj 2025: një, një listë të dëshmitarë të
25 propozuar që do të thirren nëse Trupi Gjykses del me

1 përfundimin se do të ketë një çështje për t'u gjykuar më tej;
2 dy, deklaratat dhe/ose raportet e këtyre dëshmitarëve nëse
3 ekzistojnë dhe përmbledhje të dëshmive të propozuara të
4 dëshmitarëve, si dhe parashikimin kohor për pyetjet që do të
5 nevojiten për secilin nga dëshmitarët; tre, një listë të
6 materialeve provuese që do të dorëzohen nëse do të ketë një
7 çështje për t'u vijuar më tej bashkë me mënyrën se si do të
8 kërkohet pranimi i këtyre materialeve; dhe ju lutem një
9 planifikim të provave të Mbrojtësit të Viktimave si dhe
10 mocionet që do të keni sipas rregullave 153, 155, mocione të
11 provave jogojor, dhe çdo parashtrim tjetër të protokolluar në
12 bazë të rregullores dhe urdhrit të Trupit Gjykues për
13 zhvillimin e procesit gjyqësor.

14 Njoftohen palët që të urdhërojnë Trupin -- të njoftojnë -
15 më falni - Trupin Gjykues dhe palët e tjera dhe pjesëmarrësit
16 jo më vonë se të hënën, 9 qershor 2025; një, nëse
17 kundërshtojnë pranimin e provave të propozuara nga Mbrojtësi i
18 Viktimave, dhe nëse po, cilat pjesë kundërshtojmë; dhe dy,
19 cilët dëshmitarë dëshirojnë të kundërpyesin nëse çështja do të
20 vijojë më tej dhe kohën e parashikuar për kundërpyetjen për
21 secilin nga dëshmitarët.

22 Me kaq mbyll urdhrin e njëmbëdhjetë me gojë.

23 Tani do të lëshoj një urdhër me gojë lidhur me kërkesën e
24 Mbrojtjes së Thaçit për afate për dorëzimin për pranimin e
25 materialeve që lidhen me pengimin e drejtësisë që janë

1 mbledhur përmes masave hetimore të posaçme të autorizuar nga
2 Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

3 Më 15 prill 2025, në dokumentin me numër F03120, ZPS-ja
4 dorëzoi një mocion për pranimin e materialeve që lidhen me
5 pengimin e pretenduar të këtij procesi gjyqësor.

6 Më 18 prill 2025, në parashtrimin F03127, Mbrojtja e
7 Thaçit kërkoi që Trupi Gjykses të caktonte afate ku të
8 autorizonte Mbrojtjen të: një, të dorëzonte parashtrime të
9 përditësuara sa i takon përjashtimit *in limine* të këtyre
10 materialeve brenda 30 prillit 2025; dhe të dorëzon -- pika dy,
11 pra, të dorëzonte një përgjigje ndaj mocionit të ZPS-së nëse
12 ishte e nevojshme brenda dhjetë ditësh nga njoftimi i një
13 vendimi lidhur me kërkesën për përjashtimin e materialeve.

14 Më 18 prill 2025 në parashtrimin e protokolluar F0332
15 [Sipas përkthimit], ZPS-ja u përgjigj dhe kërkoi që të
16 rrëzohej kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit.

17 Më 23 prill 2025, Mbrojtja e Thaçit u përgjigj me gojë
18 dhe tha se në fakt kërkesa duhej miratuar.

19 Pasi shqyrtuam kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit dhe
20 parashtrimet e ZPS-së lidhur me këtë aspekt, Trupi Gjykses
21 është i mendimit se debati juridik lidhur me materialet që
22 kërkon të pranohet prej ZPS-së nuk ka pse të jetë degëzuar.
23 Trupi Gjykses është i bindur që parashtrimet lidhur me
24 pranueshmërinë e materialeve të dorëzuar nga ZPS-ja mund të
25 trajtohen në mënyrë efektive në përgjigje të mocionit të ZPS-

1 së për pranimin e këtyre materialeve.

2 Sa i takon argumentit të Mbrojtjes së Thaçit Trupi
3 Gjykues ka marrë vendim dhe ka thënë se Mbrojtja ka të drejtë
4 të ketë periudhë të caktuar për të diskutuar pranueshmërinë e
5 materialeve relevante, Trupi Gjykues vëren se në vendimin
6 F02501, Trupi Gjykues, në fakt, ka vendosur se Mbrojtja e
7 Thaçit mund të përdorë të njëjtat argumente që ka parashtruar
8 në kërkesën e mëhershme për përjashtimin *in limine*. Nuk kemi
9 thënë se ka të drejtë për një periudhë të veçantë për të
10 dorëzuar për të dorëzuar parashtrimin. Rregullorja nuk
11 parashikon periudha të veçanta për litigim, pra për debate
12 juridike *in limine* sa i takon pranueshmërisë, ndonëse Trupi
13 Gjykues vlerëson se në fund të fundit kjo është në dorën e
14 Trupit Gjykues për të vendosur lidhur me këtë, e rrjedhimisht
15 rrëzojmë kërkesën e Thaçit.

16 Në fakt, nëse Mbrojtja dëshiron të kërkojë mjete juridike
17 të mëtutjeshme *in limine* lidhur me këtë çështje në një
18 parashtrim të veçantë që nuk lidhet mocionin e ZPS-së për
19 pranim të materialeve, atëherë le ta dorëzojnë këtë parashtrim
20 të veçantë po brenda afateve që ka caktuar Trupi Gjykues për
21 t'ju përgjigjur mocioneve të ZPS-së.

22 Në këtë drejtim, Trupi Gjykues vëren se kërkesa e
23 Mbrojtjes së Thaçit për zgjatjen e afatit dhe shtimin e numrit
24 të fjalëve për t'iu përgjigjur mocionit të ZPS-së edhe duke
25 marrë parasysh afatet që janë caktuar për përgjigjen e

1 parashtrimi F0320 [Sipas përkthimit], afati aty është e
2 premtë, 25 prill 2025, dhe për faktin se ZPS-ja ka thënë se
3 nuk do ta kundërshtonte shtimin e numrit të fjalëve apo
4 zgjatjen e afatit për këto përgjigje, atëherë Trupi Gjykses
5 është bindur se janë shfaqur arsye të vlefshme për zgjatjen e
6 afatit dhe numrin e -- shtimin e numrit të fjalët në mënyrë që
7 Mbrojtja e z. Thaçi të trajtojë siç duhet të gjitha aspektet
8 siç duhet në mocionin e ZPS-së me F03120.

9 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton zgjatjen e afatit për
10 të dorëzuar mocionin *in limine* dhe për t'iu përgjigjur
11 parashtrimi të protokolluar F0320 [Sipas përkthimit] deri të
12 premtën, më 2 maj 2025.

13 Sa i takon kërkesës për shtimin e numrit të fjalëve,
14 Trupi Gjykses është i mendimit se 18.000 gjithsej për
15 parashtrimet *in limine* janë të tepërta. Trupi Gjykses
16 sidoqoftë është bindur se -- Trupi Gjykses është bindur, pra,
17 se janë paraqitur arsye të vlefshme për të dorëzuar -- më
18 falni - për të shtuar numrin e fjalëve me 10.000 fjalë për
19 parashtrimet *in limine* dhe për t'ju përgjigjur mocionit të
20 ZPS-së. Sidoqoftë Trupi Gjykses ja le në dorë avokatit të
21 vendosë sesi do ta përdorë parashtrimet sepse do të duhet ose
22 të dorëzojë dy parashtrime të veçanta ose një parashtrim
23 përmbledhës.

24 Dhe këtu mbyll urdhrin e dymbëdhjetë me gojë.

25 Së fundi, Trupi Gjykses heq të gjitha datat nga kalendari

1 që ishin parashikuar deri më 8 maj 2025. Dhe do ju njoftojmë
2 kur do të jetë seanca e radhës.

3 Z. Dixon, a patët mundësi të diskutonit me kolegët për
4 atë që folëm më herët?

5 Z. DIXON: [Përkthim] Fatkeqësisht jo tani, jo lidhur me
6 këtë pikë, por do të diskutojmë lidhur me këtë sa më shpejt që
7 të jetë e mundur dhe do t'ju njoftojmë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 përgjigjeni me shkrim nëse është më lehtë.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Besoj se është dhe mënyra më e mirë
11 në fakt.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Ka gjë tjetër për të shtuar prej palëve?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kemi një aspekt, mbase është
15 pak e parakohshme që ta kërkojë që tani, Trupi Gjykses në
16 Çështjen 07 ka vendosur një afat -- ka vendosur një afat sipas
17 rregullës 119(2) për datën e synuar dhe ne në atë kohë na
18 është dukur një datë e mirë.

19 Kështu që do deshëm të dinim nëse Trupi Gjykses do të
20 jetë në gjendje të japë një datë për vendim sipas rregullës
21 130 ose të jepet një afat për Mbrojtjen për të dhënë
22 informacion sipas rregullës 119(2).

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
24 koment?

25 Z. ROWAN: [Përkthim] S'kam koment lidhur me këtë, po dua

1 të shtoj diçka tjetër.

2 Trupi Gjykses sot vendosi lidhur me shtimin e numrit të
3 fjalëve për parashtrimin e protokolluar 3056. Kjo ka qenë një
4 kërkesë e përbashkët sipas mocionit 155 dhe 153 për tri
5 dëshmitarë: 4260, 4738, 4574.

6 Ne, si ekiye të Mbrojtjes, jemi përpjekur sa herë ka qenë
7 e mundshme të punojmë së bashku, të dorëzojmë parashtrime të
8 përbashkëta dhe ju vetë e thatë sot që ne jemi koordinuar
9 shumë, kemi punuar si ekip në mënyrë që të jemi sa më efikasë
10 në punën tonë dhe në këtë rast ne kishim bërë një parashtrim
11 të përbashkët.

12 Një nga vështirësitë është që ne kemi ndonjëherë interesa
13 të ndara dhe ka aspekte të ndara që duhet të trajtojmë secili
14 prej katër ekiyeve të Mbrojtjes. Për këtë dokument bëhet fjalë
15 për tri dëshmitarë, dy prej të cilëve janë shumë të
16 rëndësishëm dhe që trajtojnë aspekte shumë të rëndësishme në
17 këtë çështje gjyqësore dhe që lidhen me shumë akuzat që janë
18 ngritur në këtë çështje gjyqësore.

19 Ne jemi përpjekur shumë, të katra ekipet, të përdorim sa
20 më pak fjalë që të jetë e mundshme. Ne shumë rrallë ju kemi
21 kërkuar ju zgjatje të numrit të fjalëve. Ka qenë domosdoshme
22 kur e kemi bërë këtë kërkesë dhe kërkesa që ne bëmë sot për
23 3000 fjalë ka qenë shtimi më minimal që mund të kërkonim ne në
24 mënyrë që të reflektonim të katër ekipet e Mbrojtjes
25 përfaqësuesit tonë.

1 Kur dorëzojmë parashtrime të veçanta, atëherë i takonte
2 që ju do kishit marrë katër dokumente të ndara me 6000 fjalë
3 gjithsej. Kështu që, ju lutem, në rastet kur kemi mundësinë
4 t'i kombinojmë ne këto parashtrimet, të na e keni parasysh
5 kërkesën kur kërkojmë 24.000 fjalë, mos na e zbrisni në 10.000
6 fjalë.

7 Kështu që ne do na duhet të pasqyrojmë interesat
8 ndonjëherë të ndara të të katër të pandehurve lidhur me këta
9 tri dëshmitarë.

10 Pra, i lutemi Trupit Gjykses ta rishqyrtojë edhe një herë
11 kërkesën tonë për shtimin e numrit të fjalëve me 3000 fjalë
12 sepse kjo na ndihmon ne të pasqyrojmë siç duhet parashtrimet
13 tona. Në qoftë se ju nuk pranoni ta bëni këtë, atëherë do t'i
14 kërkonim Trupit Gjykses që ne për secilin nga tre dëshmitarët
15 do të përgjigjet një ekip i Mbrojtjes, pra do merrni tri
16 parashtrime të ndara, 6000 fjalë secili, gjithsej 8000 [Sipas
17 përkthimit] fjalë, që është më shumë se numri i fjalëve që na
18 miratuat.

19 Prandaj, po ju kërkojmë që ta rishqyrtoni dhe një herë
20 vendimin tuaj. Ne kemi bërë minimumin, kemi përdorur sa më pak
21 fjalë që të jetë e mundshme, po nuk na mjaftojnë kaq fjalë sa
22 na dhatë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, në
24 rregull.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Edhe ZPS-ja nuk është kundër në

1 fakt, nuk besojmë se është problem që të shtohet numri i
2 fjalëve. Jemi -- kemi qenë shumë të kursyer me numrin e fjalë,
3 por është e vështirë me kaq fjalë sa na jepni ju të pasqyrojmë
4 katër ekipet e Mbrojtjes parashtrimet tona. Faleminderit.

5 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë e
7 miratojmë kërkesën tuaj.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Kam nevojë për një
10 sqarim nga ana ime. Unë sot paradite, në faqen e transkriptit
11 faqja 30, rreshti 6, unë thashë që do të kenë një numër të
12 konsiderueshëm deklaratash -- numër të konsiderueshëm
13 deklaratash që janë duke u përgatitur, deklarata viktimash, që
14 të jem i qartë që të kuptoj se cili urdhër me gojë e mbulon
15 këtë aspekt.

16 Në faqen 30 unë thashë që do t'i dorëzonim në
17 parashtrimet përkatëse brenda 28 majit, do ju informonim se
18 për çfarë bëhet fjalë, cila është baza e materialeve, por nuk
19 mendoj se do të jem gati deri më 28 maj. Arsyeja kryesore për
20 këtë është sepse duhen nënshkruar, është një proces shumë i
21 vështirë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju po
23 thoni që do të na jepni një përshkrim të çdo gjëje po
24 dokumentit -- dokumentet.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Po, po. Po, ju thashë që kjo është

1 një nga hapat e fundit që ne kishim menduar për planin tonë të
2 punës. Këto janë dokumente që kanë të bëjnë me dëmin që është
3 shkaktuar se ka shumë syresh dhe nuk do jenë gati më 28 maj,
4 por mund sigurisht që dorëzohen para se të fillojmë me provat
5 tona në korrik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
7 themi 1 korrik atëherë data e fundit?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Po, atëherë, data 1 korrik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mesa duket
10 jemi të një mendje që në 28 maj të paraqisni këto që kini,
11 ndërsa pak nga pak të vazhdoni me të tjera derisa të
12 përfundojnë në një 1 korrik. Është e qartë? Në rregull?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Po, në rregull.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Një sqarim të thjeshtë. Urdhri juaj
15 që miraton kërkesën e Thaçit për zgjatjen e kohës dhe të
16 numrit të fjalëve -- shtimin e numrit të fjalëve, vlen vetëm
17 për Thaçin apo dhe për të tjerët që janë në parashtrimin
18 F031207 [Sipas përkthimit]? Ne jemi të shqetësuar më pak sesa
19 të tjerët, pra kjo zgjatje vlen për të gjithë, të gjitha
20 ekipet e Mbrojtjes?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju do të
22 paraqisni secili veç e veç kërkesa apo jo?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne na duhen të gjitha 10.000
24 kështu që duhet të ketë parashtrime të veçanta.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, sa fjalë

1 ju duhen juve?

2 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk besoj se do të na duhet një
3 shtim i numrit. Neve jemi të shqetësuar vetëm për kohën, për
4 zgjatjen e kohës, që është 2 maji.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
6 [Përkthim] 2 maji është e përshtatshme për ju?

7 Z. TULLY: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne duhet të përgjigjemi veç e
10 veç. Nuk kemi nevojë për shtimin e numrit të fjalëve, por duam
11 të jetë data 2 maj.

12 Z. DIXON: [Përkthim] E njëjta gjë vlen dhe për --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, të
14 gjithë ju mund të paraqisni ato parashtrime që doni brenda
15 numrit të caktuar të fjalëve deri më 2 maj, kështu?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Në përgjigje të Mbrojtësit të
17 Viktimave dua të mos ketë asnjë paragjykim ndaj qëndrimit
18 tonë, pra, që t'i marrim deklaratat e viktimave deri në 1
19 korrik, dhe pastaj çështja -- paraqitja e provave nga ata do
20 të fillojë në 2 korrik.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
22 [Përkthim] Besoj do të fillojmë në korrik me këtë
23 çështje.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] E di, por nuk e di se çfarë
25 përmbajnë ato deklaratat dhe për ç'qëllim po paraqiten. Po për

1 aq sa ne do të kundërshtojmë apo potencial do t'i
2 kundërshtojmë kërkesat në bazë të neneve 155, neve duam të
3 dimë se çfarë -- për çfarë bëhet fjalë nëse do të ketë nevojë
4 që të thirren viktimat e tjerë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asnjë nuk po
6 ju përpiqet t'ju pengojë, thjesht po japim datat që duhen
7 respektuar.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë dua të konfirmoj qëndrimin
9 tonë që të kemi mundësi të vazhdojmë me çështjen për
10 dëshmitarëve ekspertë, që siç u tha më lart do t'i kemi në
11 maj, shpresojmë që me ato të vazhdojmë të jemi në rregull.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më korrigjoni
13 nëse e kam gabim, po ju thatë që ishte një numër i caktuar
14 deklarata, z. Laws.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Atë që sapo thashë unë tani, përmban
16 një numër mjaft të madh. Që ta qetësoj z. Misetiç, nuk janë
17 deklarata të cilat do t'u jepet palëve apo Gjykatës në bazë të
18 faktit që nëse kundërshtohen viktimat do të thirren të
19 dëshmojnë. Nuk do të jetë kjo gjë që do të bëjmë. Këto
20 deklarata që vijnë në bazë -- janë bërë të një procedure
21 tjetër të rregullës 153, 154, 155, dhe këtë do ta shpjegoj në
22 parashtrimin që do të bëj në maj.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Vazhdoni të jeni të mendimit
24 që do t'i thërrisni të gjithë dëshmitarët dhe do të lini kohë
25 të mjaftueshme për pyetje nga pala tjetër dhe të gjitha këto

1 do të ndodhin brenda një jave, kështu?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Një javë me mundësinë e vazhdimit në
3 javën e dytë. Por, më për më nuk besoj se do të na duhet më
4 shumë se një javë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra numri i përgjithshëm i
6 viktimave që do të dëshmojnë drejtpërdrejtë nuk është shumë i
7 madh?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Janë shumë pak, nëse do të ketë
9 ndonjë nuk mund ta jap numrin tani sepse vazhdojmë diskutimet
10 me ta, por nëse ndonjë do të dojë të dëshmojë do të jetë --
11 bëhet fjalë për një numër shumë të vogël.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni të
14 kënaqur tani lidhur me shqetësimet deri në një farë mase?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, deri në një farë mase. Por unë
16 do të doja të thoja për procesverbal se cili është qëndrimi
17 ynë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
19 asnjë dyshim për këtë.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Që ta bëj të qartë. Njerëzit që ne
21 mund të thërresim për të dëshmuar drejtpërdrejtë në korrik,
22 qershor apo kurdo të jetë, do të përcaktohen në parashtimin
23 tonë të datës 28 maj.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo na qetëson.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka njeri

1 tjetër? Nuk keni më nevojë për sqarime. Atëherë përfundojmë
2 këtu.

3 --- Seanca mbyllet në orën 14.26

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25